



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 215 Akti

Nr. 298 Vendimi
Tiranë, më 17.9.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësor, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Branko Hrvatin, në Tiranë, në datën 11 shtator 2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arjan Qafa**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1 të nenin 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), zhvilloi procedurën e zhvillimit të shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjykues në datën 15.11.2018, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.11.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa.

5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës

¹ Raporti nr. **** prot., datë 6.3.2018.

së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë dhe;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 29.7.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në datën 29.7.2020, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 3.8.2020, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 7.9.2020.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 8.9.2020.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 11.9.2020, ora 10:00, në mjediset e Pallatit

² Raporti për analizimin e aftësisë profesionale me nr. **** prot., datë 4.3.2020.

e Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Arjan Qafa ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka bërë kërkesë për shtyrjen e afatit të vendosur nga Komisioni për dorëzimin e prapësimeve/provave/shpjegimeve përfundimtare me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit. Komisioni, pasi vlerësoi këtë kërkesë, në garantim të të drejtave të subjektit për një proces të rregullt ligjor, i dha gjithë kohën e mjaftueshme për t’u mbrojtur dhe paraqitur prapësimet dhe provat tij.

20.2 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Por, referuar vendimit nr. 2/2017³ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces

³ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut dhe; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa.

23.2 Hetimi i kryer nga Komisioni është përqëndruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në datën 28.1.2017 në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme:

24. Pasurinë e llojit “tokë bujqësore”⁴ me sipërfaqe 1.639 m², e fituar me ligj. Zotëron 100% në pronësi të tij. Ka sqaruar se sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, vlera e kësaj sipërfaqe toke është 163,900 lekë (100 lekë/m²).

24.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti, ndër vite, në ILDKPKI konstatohet se kjo pasuri nuk është deklaruar më parë nga subjekti i rivlerësimit.

24.2. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: fshehje e pasurisë “arë” me sipërfaqe 1.639 m², në emër të subjektit me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në Fushë – Arrëz, në deklaratat e interesave private, ndër vite, në ILDKPKI nga viti 2003 – 2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

24.3. ZVRPP-ja Pukë/ASHK, Dega Vendore Pukë⁵, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa, figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e

⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks ***në dosjen e ILDKPKI), shkresë e nr. *** prot., datë 21.10.2016, të ZVRPP-së Pukë.

⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 8.2.2019 dhe nr. ***prot., datë 16.4.2020.

llojit “arë”, me sipërfaqe 1.639 m². Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar konstatohet se kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 30.10.2003 - bazuar në Aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. ***, datë 2.10.1992. Referuar AMTP-së nr. ***, datë 2.10.1992, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991, “Për tokën”, rezulton se subjektit të rivlerësimit i është dhënë në pronësi (si kryefamiljar) tokë gjithsej me sip. 1.716 m² në fshatin Fushë-Arrëz, nga të cilat 1,566 m² tokë arë dhe 150 m² tokë truall.

24.4. Bazuar në ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991, “Për tokën”, përfitonin tokë familjet bujqësore, ku secili anëtar i saj pjesë e certifikatës familjare datë 1.8.1991, zotëronte të drejta reale/pjesë takuese si bashkëpronar mbi këtë pasuri, pavarësisht moshës së tij.

24.5. Duke marrë në konsideratë faktin se në datën 1.8.1991 subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtin trung familjar, sipas të cilit, në referim të ligjit të mësipërm, kryetar i familjes bujqësore ka qenë babai i tij, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit: (i) se me çfarë statusi e ka përfituar këtë pasuri; (ii) për mospërputhjet lidhur me sipërfaqen e pasqyruar në AMTP dhe sipërfaqen e regjistruar në ZVRPP; si dhe (iii) të konfirmonte nëse mbi këtë pasuri janë kryer investime prej tij⁶.

24.6. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se⁷ lidhur me AMTP nr. ***, datë 2.10.1992, nuk ka dijeni për ekzistencën e tij. Nuk ka marrë në dorëzim këtë pasuri të referuar në AMTP-në e sipërcituar pasi në atë kohë ka qenë student. Për herë të parë është vënë në dijeni për ekzistencën e kësaj prone të regjistruar në emrin e tij në kohën kur po përpiqej të mblidhte dokumentacion nga ZVRPP-ja Pukë për plotësimin e deklaratës “Vetting”. Sqaron se nuk është në dijeni të përmbajtjes së plotë të këtij akti, por cilado qoftë përmbajtja e tij, deklararon me përgjegjësi të plotë se ka qenë i ndarë nga trangu familjar që prej vitit 1992 në regjistrat e gjendjes civile, por në datën 1 gusht 1991, kohë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji 7501/1991, ka qenë në përbërje familjare me prindërit e tij... Në vijim deklararon se nuk është në dijeni se si kanë vepruar komisionet e ndarjes së tokës në fshat, por se nuk ka marrë në dorëzim ndonjë AMTP. Nëse autoritetet kanë lëshuar AMTP në emrin e tij dhe nëse në emrin e tij figuron marrja në dorëzim e një akti të tillë, thekson se ky veprim është bërë pa dijeninë e tij dhe kërkon ekzaminimin e nënshkrimit të tij në rastin eventual të ekzistencës së shënimeve në emrin e tij... Si përfundim, deklararon se nuk ka aplikuar ndonjëherë në ZVRPP-në Pukë për regjistrimin e këtij akti, nuk disponon ndonjë certifikatë pronësie për këtë pronë dhe se rrugët ligjore për ndjekjen e ligjshmërisë së këtij akti rregullohen nga ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, sipas të cilit parregullsitë dhe paligjshmëritë e AMTP-ve korrigjohen nga institucionet shtetërore kompetente të krijuar me ligj pikërisht për këtë qëllim.

24.7. Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm i kërkoi ASHK-së, Degës Vendore Pukë⁸ informacion se kush e ka depozituar AMTP-në nr. ***, datë 2.10.1992, mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi i pasurisë së sipërcituar, në emër të shtetasit Arjan Qafa.

24.8. ASHK-ja, Dega Vendore Pukë⁹ informoi se pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “arë” me sip. 1639 m², me pronar Arjan Ll., Qafa, është regjistruar në sistemin e pasurive sipas Aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 2.10.1992 dhe se ky akt është depozituar pranë ZVRPP-së Pukë (sot Zyra Vendore e ASHK-së Pukë) me procesverbal nga punonjësi i zyrës së AMT-Pukë më datë 15.11.2007, bashkëlidhur të cilit është dërguar edhe kopje e formularit nr. ***.

⁶ Pyetëtori nr. 3, pyetja nr. 2.

⁷ Përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dërguar me e-mail-in datë 23.4.2020.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 5.5.2020.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2020.

24.9. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua Këshillit të Qarkut Shkodër¹⁰, duke i kërkuar konfirmimin e vërtetësinë së AMTP-së nr. ***, datë 2.10.1992, nëse është nxjerrë nga organet e varësisë të pushtetit vendor, nëse ky akt është dërguar prej tyre në ZVRPP-në Pukë, si dhe informacion se mbi cilat kritere shtetasi Arjan Ll., Qafa e ka përfituar këtë tokë në pronësi, referuar legjislacionit në fuqi për kohën.

25. Këshilli i Qarkut Shkodër¹¹ informoi se në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, i ndryshuar, plotësimi i dokumentacionit AMTP dhe dhënia e këtij dokumentacioni subjekteve të ligjit është detyrim ligjor i komisionit të ndarjes së tokës në fshat. Zyra e ish-Kadastrës aktualisht ZAMT (Zyra e Administrimit dhe e Mbrojtjes) Pukë, ka vendosur në dispozicion të këtij komisioni dokumentacionin kadastral të vitit 1985 – 1990, libër ngastre “LN”, hartë kadastrale, të cilët përcaktojnë llojin e tokës “zërin kadastral objekt i ligjit 7501”, si dhe pozicionin gjeografik të sipërfaqes objekt plotësimi. Dokumentacioni ligjor AMTP është plotësuar nga komisioni në dy kopje: për poseduesin e tokës, si edhe për zyrën e ish-Kadastrës ZAMT Pukë, kopje e së cilës i është përcjellë ZVRPP-së Pukë për të vijuar procesin e regjistrimit.

25.1. Referuar të dhënave dhe dokumentacionit të administruar në dosje, nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë marrë pjesë me veprime aktive në regjistrimin e kësaj pasurie në emrin e tij. Gjithashtu, megjithëse ky akt (AMPT-ja) përpilohej në dy kopje dhe njëra prej kopjeve i jepej në dorëzim pronarit, nuk u provua, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se një kopje e këtij akti t’i jetë dorëzuar subjektit në momentin e përpilimit të tij.

25.2. Gjithsesi, nga këqyrja me sy të lirë e këtij akti duket se është i ndryshëm si format nga AMTP nr. ***, datë 2.10.1992, sipas të cilit ka fituar tokë në pronësi familja e subjektit të rivlerësimit, me kryefamiljar z. Ll. Q. Duket se AMTP-ja nr. ***, datë 2.10.1992 (sipas së cilës fiton pasuri dhe subjekti i rivlerësimit si pjesëtar i familjes bujqësore, pjesë e të njëjtit trung familjar në datë 1.8.1991), është akt i lëshuar nga komisionet e ndarjes së tokës në fshat i punuar me makinë shkrimi. Ndërkohë AMTP-ja mbi bazën e së cilës subjekti i rivlerësimit ka fituar pasurinë objekt hetimi (AMTP nr. ***, datë 2.10.1992), megjithëse është nxjerrë në të njëjtën datë, duket se ka format tjetër - e punuar në formatin kompjuterik (word/excel).

25.3. Për sa më sipër duket se: (i) subjekti e ka fituar këtë pasuri në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës dhe Komisioni ngre dyshimin e arsyeshëm se kjo pasuri është fituar me dokumentin AMTP të lëshuar nga komisionet e ndarjes së tokës në fshat, i cili nuk ka formën që kishin/janë paraqitur AMTP-të e kohës; si dhe (ii) subjekti ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, pasi, megjithëse pretendon se është njohur me ekzistencën e kësaj pasurie në momentin e mbledhjes së dokumentacionit për plotësimin e deklaratës “Vetting”, nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën juridike lidhur me këtë pasuri, të regjistruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në emrin e tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

26. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit¹² dhe sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke depozituar si provë të re shkresën¹³ e datës 5.8.2020 të kryetarit të fshatit Fushë – Arrëz.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 5.5.2020.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020.

¹² (i) Prapësimet/provat e depozituara në datën 24.8.2020 – protokolluar në Komision me nr. *** prot. (ii) prapësimet/provat e dërguara në rrugë elektronike me e-mail datë 25.8.2020; dhe (iii) prapësimet/provat e dërguara në rrugë elektronike me e-mail datë 7.9.2020.

¹³ Shkresë nr. extra prot., datë 5.8.2020.

26.1. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka mbajtur qëndrimin se nuk është përfitues i ligjit për tokat bujqësore për të cilin është lëshuar AMTP-ja me nr. ***, nuk ka pasur dijeni për këtë akt, dhe se menjëherë pas marrjes dijeni, ka vepruar duke verifikuar ligjshmërinë e aktit nga organet që kanë pasur për detyrë ta lëshojnë atë.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

27. Rezulton se në dosjen e ILDKPKI-së (Ankes ***) gjendet shkresa e ZVRPP-së Pukë¹⁴ e datës 21.10.2016, nëpërmjet të cilës subjekti i rivlerësimit është informuar se në emrin e tij është regjistruar edhe pasuria objekt vlerësimi, e llojit “tokë arë” me sip. 1.639 m².

27.1. Duket se mbi bazën e këtij informacioni të marrë nga ZVRPP-ja Pukë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, ka deklaruar pasurinë e llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqe 1.639 m² – të fituar me ligjin nr. 7501, dhe se zotëron 100 % pjesë të saj.

27.2. Referuar pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

27.3. Komisioni vëren se shkresa informuese e ZVRPP-së Pukë drejtuar subjektit¹⁵ (depozituar si dokument justifikues i vërtetësisë së deklaratimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit), referon se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, por nuk pasqyron mënyrën e fitimit të saj.

27.4. Në këtë kuptim, deklarimi i bërë nga subjekti në deklaratën “Vetting” se kjo pasuri është fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndyshuar, provon dijeninë e tij të plotë për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe, si rrjedhojë, për ekzistencën e dokumentit AMTP, si dokument i vetëm mbi bazën e të cilit mund të përfitohej tokë bujqësore nëpërmjet ligjit të sipërcituar.

27.5. Komisioni vlerëson se me deklarimin e kësaj pasurie subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka depozituar dokumente justifikues për vërtetësinë e deklarimeve të tij.

Pra, nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, megjithëse ka deklaruar se është fituar me ligjin nr. 7501.

27.6. Në shkresën e datës 5.8.2020 të krytarit të fshatit Fushë-Arrëz drejtuar subjektit të rivlerësimit (depozituar si provë e re mbas dërgimit të rezultateve të hetimit), referohet se: *[...]në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me ligjshmërinë e aktit nr. ***, datë 2.10.1992 dhe AMTP-së me nr. ***, datë 2.10.1992, ju sqarojmë se kërkesa e paraqitur në muajin tetor të vitit 2016 i ka kaluar për trajtim sektorit të menaxhimit të tokave bujqësor pranë Bashkisë Fushë-Arrëz nga kryesia e fshatit Fushë-Arrëz. Në vijim sqarojmë se procesi i regjistrimit të pasurive në të gjithë territorin e fshatit Fushë-Arrëz është bërë nga zbatimi i projektit të azhurnimit dhe regjistrimit të pronave dhe jo me aplikim fillestar nëpërmjet pronarëve të pronësisë. Mbi këtë bazë ka patur edhe parregullsi të cilat janë rregulluar në vijimësi[...].*

27.7. Komisioni vëren se, megjithëse kjo shkresë citon se subjekti ka paraqitur kërkesë në muajin tetor të vitit 2016 lidhur me ligjshmërinë e AMTP-së mbi bazën e së cilës është fituar pronësia e pasurisë objekt vlerësimi – subjekti nuk e ka depozituar këtë kërkesë, e cila do të provonte përpjekjen e tij për verifikimin në kohë të ligjshmërisë së këtij akti. Për më tepër, sikurse u evidentua më sipër në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka pasqyruar një rrethanë

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2016.

¹⁵ Mbi bazën e së cilës e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e rivlerësimit kalimtar - *Vetting*.

të tillë – e cila do mbështeste pretendimet e tij për situatën faktike mbi bazën e së cilës është fituar kjo pasuri.

27.8. Si konkluzion, në vlerësim të provave të administruara në dosje, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se z. Arjan Qafa ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, pasi, megjithëse ka pasur dijeni të plotë se e ka përfituar këtë pasuri në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës, e ka fshehur këtë rrethanë në deklaratën “Vetting”, si edhe nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhuara ligjore për të rregulluar situatën faktike-juridike lidhur me këtë pasuri, çka cenon figurën e gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë.

28. Zotëron 1/10 e pasurisë së llojit “tokë bujqësore”¹⁶ me sipërfaqe totale 1.955 m², e ndarë në pasuritë: (i) parcela me nr. pasurie * me sip. 6000 m²; (ii) parcela me nr. pasurie *** me sip. 428 m²; si dhe (iii) parcela me nr. pasurie *** me sip. 927 m².**

28.1. Subjekti deklaron se pjesën takuese mbi këtë pasuri e ka fituar nëpërmjet trashëgimisë ligjore prej babait të tij. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk ka informacion lidhur me çmimin, sepse është fituar me ligj, por në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë është caktuar 100 lekë/m².

28.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti, ndër vite, në ILDKPKI konstatohet se kjo pasuri nuk është deklaruar më parë nga subjekti i rivlerësimit.

28.3. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: fshehje e pjesës takuese prej 1/10 e subjektit, në tokën me sip. totale 1,955 m², në z. k. ***, në Fushë-Arrëz, fituar nga trashëgimia ligjore e babait, në deklaratat e interesave private 2006 – 2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

28.4. ZVRPP-ja Pukë/ASHK, Dega Vendore Pukë¹⁷, konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në bashkëpronësi në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme pasuritë, si vijon: (i) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “arë”, me sip. 600 m²; (ii) pasuria ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë “arë”, me sip. 428 m²; si dhe (iii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “arë”, me sip. 927 m².

28.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje duket se fillimisht kjo pasuri (e pandarë) është fituar bazuar në ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991, “Për tokën”. Referuar AMTP-së nr. ***, datë 2.10.1992, në mbështetje të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, i është dhënë familjes së z. Ll. D.Qafa., (babai i subjektit, kryefamiljar) tokë në pronësi gjithsej 2,562 m², e cila është ndarë në tri pjesë dhe duket se është regjistruar në regjistrat hipotekorë në datën 31.10.2003.

28.6. Referuar certifikatës për gjendjen familjare, datë 1.8.1991, konstatohet se z. Ll. D. Q., (si kryefamiljar), ka qenë në certifikatë familjare së bashku me nëntë anëtarë të tjerë të familjes, ku pjesë përbërëse është dhe subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Ll., Qafa.

28.7. Si rrjedhim, duket se në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991, “Për tokën”, si edhe në referim të AMTP-së nr. ***, datë 2.10.1992, subjekti i rivlerësimit ka zotëruar të drejta reale mbi këtë pasuri/ka qenë bashkëpronar, duke zotëruar ligjërisht 1/10 pjesë të saj, para se babai i tij të ndërronte jetë.

28.8. Në datën 20.10.2016, me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, është nxjerrë vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore¹⁸ me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë

¹⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI), shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2016, e ZVRPP-së Pukë.

¹⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 8.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 16.4.2020.

¹⁸ Dokumenti “Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016.

ligjore për trashëgimlënësin, z. Ll.D.Q. Mbi bazën e këtij vendimi janë njohur 10 trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit, z. Ll.Q., dhe duket se pas depozitimit të këtij vendimi në zyrën hipotekore Pukë është bërë regjistrimi i pasurive të mësipërme në emër të 10 trashëgimtarëve ligjorë, bashkëshortes së tij dhe nëntë fëmijëve, duke marrë në konsideratë faktin se një nga fëmijët ka ndërruar jetë. Ndërkohë, referuar certifikatës familjare të datës 1.8.1991, pjesë përbërëse e gjendjes familjare të z. Ll.D.Q., kanë qenë bashkëshortja e tij dhe tetë fëmijë.

28.9. Për sa më sipër, nga analizimi i gjithë dokumentacionit të administruar lidhur me këto pasuri dhe në mbështetje të kuadrit ligjor të kohës, si dhe vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, datë 20.10.2016, duket se subjekti i rivlerësimit zotëron 1/10 e kësaj pasurie të fituar me ligj + 1/10 e pjesës takuese të babait të tij, të fituar me dëshmi trashëgimie.

29. Nga analiza e të dhënave dhe dokumentacionit të administruar rezulton se: (i) subjekti nuk ka deklaruar këtë pasuri, të drejtat reale mbi të/pjesën takuese që zotëronte, as në deklaratën fillestare të pasurisë, dhe as në DPV-të për vitet 2004 – 2016; dhe (ii) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për pjesën takuese që zotëron mbi këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

30. Pasi iu kërkuan shpjegime lidhur me konstatimet e mësipërme, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, nuk ka qenë në dijeni të AMTP-së nr. ***, datë 2.10.1992, duke argumentuar se ky akt i përket babait të tij si kontribues i krijimit të ish-kooperativave bujqësore dhe si kryefamiljar në datën 2.10.1992.

30.1. Në vijim të shpjegimeve të tij, subjekti pretendon se konstatimet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi në momentin e lëshimit të këtij akti në datën 2.10.1992, nuk ka qenë në përbërje familjare me babain e tij, nuk ka qenë anëtar i familjes bujqësore dhe subjekt i përfitimit të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

30.2. Subjekti ka depozituar si provë të re, shkresën¹⁹ e datës 5.8.2020 të kryetarit të fshatit Fushë- Arrëz, nëpërmjet të cilës, ndër të tjera, informohet se zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, në ish-kooperativën bujqësore të fshatit Fushë-Arrëz, për shkak të sipërfaqes së vogël të tokës bujqësore në dispozicion për t’u shpërndarë, në këtë fshat, është bazuar në kufijtë e vjetër të kontribuesve të krijimit të ish-kooperativave bujqësore dhe gjendjen civile në momentin e lëshimit të AMTP-së.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

31. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, parashikon kalimin në pronësi të tokës bujqësore te anëtarët e kooperativës bujqësore.

31.1. Sipas pikës 5 të VKM-së nr. 230, datë 22.7.1991, “Për krijimin e komisioneve të tokës”, Komisioni, përcakton në bashkëpunim me fshatarët, vendin dhe sipërfaqen e tokës së secilit, dhe përpilon në dy kopje aktin e marrjes së tokës nga çdo familje, me firmë të kryetarit të Komisionit, dhe të specialistit të autorizuar nga komisioni i rrethit, si dhe të kryefamiljarit që merr tokën.

31.2. Sipas pikës 4 të udhëzimit nr. 2, datë 2.8.1991 “Për funksionimin e komisioneve të tokës të rretheve të fshatrave”, komisioni i tokës në fshat, në bazë të të dhënave për tokën dhe përbërjes familjare, cakton sipërfaqen e tokës në metër katrorë për frymë dhe sipërfaqen e tokës për çdo familje, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

¹⁹ Shkresa nr. extra prot., datë 5.8.2020 – drejtuar subjektit të rivlerësimit.

31.3. Ndërsa, referuar pikës 2 të VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991.

31.4. Në referim të dispozitave të mësipërme, Komisioni çmon se nuk qëndron pretendimi i subjektit se ai nuk është përfitues nga AMTP-ja nr. ***, datë 2.10.1992, për shkak nuk ka qenë në përbërje familjare me babain e tij në momentin e lëshimit të këtij akti.

31.5. Duke qenë se rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit në datën 1.8.1991 ka qenë në përbërje familjare me babain e tij, në emër të të cilit është lëshuar AMTP-ja nr. ***, datë 2.10.1992, si kryetar i familjes bujqësore, Komisioni çmon se rrjedhimisht subjekti zotëron pjesën e tij takuese nga toka që i është dhënë familjes bujqësore ku bënte pjesë.

31.6. Gjithsesi, Komisioni vëren se kjo pasuri është fituar me ligj dhe nuk mund të ketë dyshime për krijimin e saj. Në këtë këndvështrim, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se në atë kohë subjekti ka qenë student, mund të konsiderohen bindëse shpjegimet e tij për mospasjen dijeni asohe të lëshimit të aktit të shpërndarjes së tokës bujqësore, mbi bazën e të cilit edhe ai ka fituar të drejta mbi pasurinë objekt vlerësimi.

31.7. Si konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pasaktësitë në deklaram lidhur me këtë pasuri janë pa pasoja konkrete dhe, si të tilla, ato nuk kanë prodhuar efekte rënduese gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

32. Zotëron 1/3 e pasurisë së llojit “tokë bujqësore”²⁰ me nr. pasurie *, me sipërfaqe totale 6.000 m², e ndodhur në fshatin *** të rrethit Kurbin, blerë me kontratën nr. ***, datë 7.4.2000. Pjesa takuese e subjektit – me vlerë 400,000 lekë.**

32.1. Subjekti ka deklaruar se 1/3 e kësaj prone është blerë me kontributin e nënës së tij, znj. Gj.Q., e cila është shkëputur në vitin 2009, konfirmuar me deklaratën noteriale të datës 25.9.2009, me nr. *** dhe deklaratën nr. ***, datë 26.1.2017. Kjo pasuri (sipërfaqja totale prej 6.000 m²) është blerë për çmimin prej 600,000 lekësh dhe se nga kjo shumë e paguar, 400,000 lekë kanë si burim të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit dhe pjesa tjetër prej 200,000 lekësh është kontribut i nënës së subjektit, znj. Gj.Q.

32.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: (i) referuar deklaramit fillestar (deklarata e dorëzuar në ILDKPKI, datë 15.3.2004), subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “tokë bujqësore” me sip. 6.000 m², e ndodhur në fshatin ***, Kurbin, blerë me të ardhurat e familjes, pjesa që zotëron 100 %, nuk ka deklaruar vlerën e kësaj pasurie; (ii) referuar DPV-së për vitin 2009 subjekti ka deklaruar se është pakësuar pasuria e përbashkët me nënën deklaruar para vitit 2004, nga 6.000 m² bie në 4.000 m², sipas deklaratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.5.2009, kjo pasuri e paluajtshme e llojit “tokë bujqësore arë” me nr. ***. Subjekti deklaroi se nëna e tij merr sipërfaqen prej 2.000 m².

32.3. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: deklarim i pasaktë nga subjekti për pjesën takuese të tij prej 1/3, në tokën me sip. 6000 m², pasi referuar dokumentacionit të paraqitur rezultoi se nëna e tij zotëron 1/3 dhe vetë subjekti 2/3 ose 4.000 m².

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

34. ZVRPP-ja Kurbin²¹, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria e llojit “tokë arë” me sipërfaqe 4.000 m², e ndodhur në fshatin ***, Kurbin.

²⁰ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (i) kontratë shitje nr. ***, datë 7.4.2000; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.2017; (iii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.9.2009 dhe; (iv) shkresë nr. *** prot., datë 17.10.2016 e ZVRPP-së Kurbin.

²¹ Shkresa nr. ***prot., datë 8.2.2019.

34.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në datën 7.4.2000, subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë e llojit “tokë arë” me sip. 6.000 m², të ndodhur në fshatin ***, Kurbin, për vlerën 600,000 lekë.

34.2. Gjithashtu, rezulton se me anë të dokumentit deklarativ noteriale “bashkëpronësi”²² të datës 25.9.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pasurinë prej 6.000 m² të llojit “tokë arë” të blerë në datën 7.4.2000 nuk e ka blerë vetëm me kontributin e tij financiar, por edhe me kontributin e nënës së tij, znj. Gj.Q., kontribut i cili është bërë në 1/3 e kësaj pasurie. Kjo deklaratë është bërë me qëllim regjistrimin e kësaj pasurie edhe në emrin e nënës së subjektit.

34.3. Mbi bazën e kësaj deklarate, ZVRPP-ja Kurbin në vitin 2009 ka bërë ndarjen e pasurisë së llojit “tokë arë” me sip. 6.000 m² në dy pasuri të veçanta dhe konkretisht: pasurinë e llojit “tokë arë” me sip. 4,000 m² në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasurinë e llojit “tokë arë” me sip. 2.000 m² në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit.

34.4. Subjekti i rivlerësimit, me dorëzimin e deklaratës “Vetting” ka deklaruar se zotëron 1/3 e pasurisë së llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqe totale 6.000 m², të blerë në datë 7.4.2000, por se referuar dokumentacionit rezulton se zotëron 2/3 e kësaj pasurie.

34.5. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar në dosje, deklaratimeve të bëra, ndër vite, nga subjekti lidhur me këtë pasuri, si dhe shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 3²³, Komisioni vlerëson se është *lapsus* deklarimi i bërë nga subjekti me dorëzimin e deklaratës “Vetting” se zotëron 1/3 pjesë pasurisë së llojit “tokë” me sipërfaqe totale 6.000 m², të blerë në datën 7.4.2000.

34.6. Gjithsesi, duket se subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, pasi duhej të deklaronte se zotëron 100 % në emër të tij pasurinë me nr. ***, të llojit “tokë arë” me sipërfaqe 4.000 m², pasuri e cila vërtet rrjedh nga pasuria me sipërfaqe 6.000 m² e blerë nga subjekti në vitin 2000, por rezulton si pasuri e regjistruar veçmas në emër të subjektit në regjistrat hipotekorë që prej vitit 2009.

34.7. Siç u evidentua më sipër, referuar deklaratës noteriale të vitit 2009, subjekti pretendon se për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2000 nëna e tij ka kontribuar me shumën prej 200,000 lekësh dhe, si rrjedhim, i takon 1/3 pjesë e pasurisë.

34.8. Nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti lidhur me këtë pasuri, duket se pretendimet e tij për pagesën e 1/3 të çmimit të blerjes së kësaj pasurie nga nëna e tij në vitin 2000 mbeten të karakterit deklarativ dhe nuk përputhen me kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të datës 7.4.2000.

34.9. Nga analiza financiare e kryer duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për blerjen e kësaj pasurie.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

35. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ.

35.1. Por, Komisioni vëren se gjatë seancës dëgjimore subjekti ka pretenduar se në vitin 2000 i ka pas marrë hua nënës së tij shumën prej 200,000 lekësh, shumë e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. Për këtë arsye, në vitin 2009 ka kaluar në emër të nënës së tij 1/3 e kësaj pasurie – që i përgjigjet vlerës prej 200,000 lekësh në momentin e blerjes së saj.

²² Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.2009.

²³ Përgjigjet e pyetjes nr. 3/ pyetësori nr. 3, dërguar me e-mail-in, datë 23.4.2020.

35.2. Gjithashtu, me dërgimin e prapësimeve subjekti ka pretenduar reduktimin e shpenzimeve jetike të përlogaritura nga Komisioni për periudhën deri në datën 7.4.2000.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

36. Siç u evidentua më sipër, referuar deklaramit fillestar (deklarata e dorëzuar në ILDKPKI, datë 15.3.2004), subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “tokë bujqësore” me sip. 6.000 m², e ndodhur në fshatin ***, Kurbin, blerë me të ardhurat e familjes dhe se e zotëron 100 % në emrin e tij këtë pasuri.

36.1. Konstatohet se nga vetëdeklarimi i bërë në deklaratën fillestare të pasurisë, familja e subjektit përbëhet vetëm prej tij si kryefamiljar (anëtar i vetëm i familjes). Gjithashtu, në këtë deklaratë nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar detyrim ndaj personave të tretë, në këtë rast shumën e pretenduar gjatë seancës dëgjimore si të marrë hua nga nëna e tij për blerjen e kësaj pasurie.

36.2. Komisioni vëren se deklaramet e bëra nga subjekti lidhur me këtë pasuri, në dukje janë kontradiktore, pasi në deklaratën noteriale të vitit 2009 dhe gjatë hetimit administrativ ka shpjeguar se nëna e tij ka kontribuar në vlera monetare për blerjen e kësaj pasurie, ndërsa gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se i ka marrë asaj hua shumën prej 200,000 lekësh – me qëllim plotësimin e çmimit për blerjen e kësaj pasurie.

36.3. Për më tepër, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e nënës së tij, të pretenduara si të dhëna prej saj në vitin 2000 për blerjen e kësaj pasurie.

36.4. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se referuar kontratës së shitblerjes, kjo pasuri është blerë vetëm nga subjekti i rivlerësimit dhe se nuk qëndrojnë pretendimet se nëna e tij ka kontribuar në vitin 2000 me shumën prej 200,000 lekësh për blerjen e saj.

36.5. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit lidhur me reduktimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në datën 7.4.2000 (datë në të cilën është blerë pasuria), mbeten të karakterit deklarativ.

36.6. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruar/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ –

36.7. Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën deri në datën 7.4.2000, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, për blerjen e pasurisë llojit “tokë arë” me sip. 6.000 m², të pasqyruar në tabelën, si vijon:

Tabela nr. 1

Analiza financiare për periudhën deri më 7.4.2000	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga pagat e subjektit ²⁴	902,548
Total të ardhurat	902,548
Shpenzime jetese ²⁵	402,246
Total shpenzime	402,246
Tokë bujqësore e blerë më 7.4.200	600,000

²⁴ Referuar dokumentacionit të administruar aneks *** dosjen e ILDKPKI-s: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 13.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat; dhe (ii) vërtetimin nr. *** prot., datë 18.10.2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë.

²⁵ Shpenzimet e jetesës për periudhën 1996-2000 janë llogaritur, si vijon: (i) për periudhën 1996 – 1997 si 80 % e të ardhurave; (ii) për periudhën 1998 – 1999 shpenzimet e jetesës janë llogaritur me 5,000 lekë/person në muaj ose 60,000 lekë në vite; dhe (iii) për vitin 2000 shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas ILDKPKI-së në shumën 9,000 lekë/person në muaj.

Total pasuri	600,000
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	- 99,698

36.8. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2000.

37. Pasuria e llojit “pyll”²⁶ me sip. 1.000 m², e ndodhur në malin Shëngjin, me vlerë 200,000 lekë, blerë me kontratën nr. *, datë 16.1.2008. Subjekti deklaron se zotëron 100 % pjesë të kësaj pasurie, por nuk ka saktësuar burimin e krijimit të saj (duket se fjalia është e ndërprerë – referohen të ardhurat dhe...por jo burimi se nga vijnë).**

37.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV-së për vitin 2008 subjekti ka deklaruar shtesë pasurie të paluajtshme të llojit “tokë pyll” me sip. 1.000 m², ndodhur në fshatin *** Shëngjin, Lezhë, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2008, me vlerë 200,000 lekë. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

37.2. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur për pasurinë “pyll” me sip. 1.000 m² në Lezhë.

37.3. Referuar dokumentacioni të administruar në dosje²⁷ konfirmohet se në emër të subjektit figuron e regjistruar blerë pasuria e llojit “pyll” me sip. 1,000 m², ndodhur në fshatin *** Shëngjin, Lezhë, blerë me kontratën²⁸ e datës 16.1.2008 për vlerën 200,000 lekë.

37.4. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi këtë pasuri, por nga verifikimi i deklaratës “Vetting” nuk është plotësisht i qartë burimi i krijimit të kësaj pasurie.

37.5. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të konfirmonte nëpërmjet deklarimeve të tij burimin e krijimit të kësaj pasurie.

37.6. Rezulton se me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e saj.

37.7. Gjithashtu, Komisioni kërkoi subjektit shpjegime lidhur me vlerën në dukje të ulët për blerjen e kësaj pasurie dhe nëse ka pasur trajtim preferencial në përcaktimin e çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie.

37.8. Në prapësimet e dërguara, subjekti ka shpjeguar se referuar VKM-së nr. 653, datë 29.9.2007, “Për miratimin e çmimeve të trojeve në hartat përkatëse për qarqet e Lezhës, Durrës, Korçë dhe Kukësit”, çmimi i miratuar për shitjen pasurisë së llojit “pyll” në *** Shëngjin është 158 lekë/m². Si rrjedhim, referuar këtij çmimi, sipërfaqja prej 1.000 m² “pyll” në Malin e Shëngjinit do kishte vlerën prej 158,000 lekësh (1,000 m² * 158 lekë/m²).

37.9. Për sa më sipër, Komisioni i vlerëson bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, por subjekti ka kyer deklarim të pasaktë lidhur me këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen e saj.

38. Analiza financiare/ligjore e pasurisë në formë likuiditetesh cash të deklaruar nga bashkëshortja e subjektit në deklarin për herë të parë në DPV-në e vitit 2008, si dhe e pasurisë/të ardhurave në formë likuiditetesh cash, pretenduar si të krijuara prej interesave të përfituara nga huadhëniet ndër vite

²⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (i) kontratë shitblerje nr. ***, datë 16.1.2008; dhe (ii) vërtetimi i ZVRPP-së Lezhë.

²⁷ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në ILDKPKI, si edhe shkresa e ZVRPP-së Lezhë nr. *** prot., datë 19.2018 përcjellë me shkresën e ZQRPP nr. *** prot., datë 26.2.2018 - aneks nr. *** pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

²⁸ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2008.

38.1. Në deklaratën “Vetting” personi i lidhur ka deklaruar të ardhura totale në shumën prej 80,000 euro të krijuara: (i) paga e marrë gjatë periudhës së studimeve në universitet nga viti 2000 – 2004, punuar pa dokumente – të ardhura këto të cilat u janë shtuar edhe paga e viteve 2005, të cilat deri në vitin 2006 ia ka dhënë kundrejt interesit prej 3% vëllait të saj për të ushtruar aktivitet privat (duke deklaruar se në këtë aktivitet ka punuar edhe vetë, duke ia bashkëngjitur këtë shumë të ardhurave të saj kundrejt interesit – të cilat i ka marrë në prag të martesës) – totali shuma prej 70,000 euro; (ii) para martesë – prindërit, vëllai dhe motra i kanë dhuruar shumën prej 10,000 euro.

38.2. Nga verifikimi dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në vitin 2008 subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. K. Q., (P.) dhe, si rrjedhim, në DPV-në e vitit 2008 bashkëshortja e tij në cilësinë e personit të lidhur ka deklaruar pasurinë që zotëronte veçmas.

38.3. Referuar DPV-së 2008 konstatohet se në rubrikën “Deklarimi i interesave private, pasuritë e pluajtshme – pasuritë e luajtshme”, personi i lidhur, znj. K.Q., ka deklaruar: (1) **pasurinë në formë likuiditetesh cash në shumën 70,000 euro**, me burim krijimi të ardhurat e përfituara prej saj prej vitit 2000 – 2008, si vijon: (i) për vitet 2000 – 2004 deklaroi se ka punuar *part-time* pas orarit të shkollës si shitëse në një dyqan rrobash; (ii) për periudhën shtator 2004 – shtator 2008 ka punuar si mësuese në shkollën e mesme ***, të rrethit Lezhë dhe; (iii) për periudhën mars 2005 – shtator 2008 ka punuar *part-time* pasdite në personin fizik “E. P.,” (i vëllai), si bashkëpronare në një videotekë (shitje disqesh dhe kasetash); dhe (2) **shuma 10,000 euro**, me burim krijimi – dhuratë për martesë nga vëllai E., motra D., dhe babai i saj²⁹.

38.4. Konstatimi i ILDKPKI-së: (i) deklarim i rremë në deklaratën “periodike/vjetore 2008” për të ardhurat *part-time* të bashkëshortes, punësuar në aktivitetin e vëllait, si person fizik, nga mars 2005 – shtator 2008. Ky aktivitet rezulton se është regjistruar në QKB në mars 2006, ndërsa në bashki në vitin 2007; dhe (ii) shuma prej 70,000 euro e deklaruar nga znj. K.Q., nga puna *part-time*, duke qenë e padokumentuar, mbetet e paprovuar, rrjedhimisht, nuk përfshihet as në të ardhurat e ligjshme, dhe as si burim financimi për blerje apo për krijim të ardhurash të ligjshme. Po kështu, edhe shuma prej 10,000 euro, e pretenduar e dhuruar *cash* nga familjarët.

Hetimi i kryer nga Komisioni

39. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti në ILDKPKI me qëllim dokumentimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 70,000 euro, duket se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e ssubjektit nga puna *part-time* si shitëse në një dyqan rrobash (vitet 2000 – 2004) dhe puna *part-time* në personin fizik “E.P.,” (vitet 2005 – 2008).

39.1. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e bashkëshortes, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i shumës prej 70,000 euro të disponuar si gjendje *cash* para martesë dhe deklaruar prej saj në deklarinë e bërë veçmas për herë të parë në vitin 2008, si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të konfirmonte nëse të ardhurat e pretenduara si të përfituara në vazhdimësi nga bashkëshortja e tij në vite janë disponuar *cash* apo identifikohen

²⁹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI): (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.10.2012 e shtetasit A., (E.) P.; (ii) certifikatë e regjistrimit në organin tatimor e vitit 2006 për E.P., + vendim nr. ***, datë 2.3.2006 për regjistrimin e E.P., si person fizik me aktivitet “tregtim artikuj industrialë” + certifikatë personale + fotokopje e printuar e Niptit (***) + shkresë e DRT Lezhë nr. ***, datë 23.7.2014; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017 e shtetasve M.P., dhe D.L., (e ëma dhe motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit); (iii) fotokopje e dokumentit, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto të K.P., mesatare, për vitet 2004 - 2007, lëshuar nga Njësia Administrative ***, Bashkia Lezhë dhe; (iv) fotokopje e dokumentit, vërtetim lëshuar nga DAR Lezhë për bazën e vlerësueshme ku referohen të ardhurat e realizuara nga K.P., për periudhën 1.12.2007 – 31.12.2007.

në llogari bankare të saj, para deklarimit të saj për herë të parë, si dhe meqenëse kjo shumë në momentin e deklarimit është disponuar *cash* të deklaronte se ku janë mbajtur këto vlera monetare³⁰.

39.2. Në përgjigje të kërkesave dhe pyetjeve të bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit pretendon se³¹ bashkëshortja ka përfituar të ardhura: (i) nga puna e kryer *part-time* në shoqërinë “****” sh.p.k., për periudhën 1.10.2000 – 31.8.2004, në total në shumën prej 2,820,000 lekësh; (ii) të ardhura nga puna si mësuese në shkollën ***, Lezhë, për periudhën dhjetor 2004 – shtator 2008, në total shumën 984,381 lekë; dhe (iii) të ardhura të përfituara nga puna *part-time* në biznesin e të vëllait për periudhën mars 2005 – shtator 2008, në total shumën prej 1,575,000 lekë.

39.3. Pra, subjekti pretendon se bashkëshortja për periudhën tetor 2000 – shtator 2008 ka përfituar totalin e të ardhurave nga puna e kryer në shumën prej 5,379,381 lekësh.

39.4. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk di që bashkëshortja të ketë pasur llogari të tjera bankare para martese, veç atyre të deklaruara në DPV-të përkatëse dhe se shuma prej 70,000 euro ka qenë në qarkullim dhe përdorim të bashkëshortes dhe normalisht është mbajtur në banesën e saj dhe të familjes së saj. Pas martese një pjesë e këtyre parave kanë vijuar të qëndrojnë në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes, ndërsa pjesa tjetër është përdorur sipas kontratave respektive të deklaruara në DPV.

39.5. Në vijim, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga kjo shumë e të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja e saj – një pjesë të kursimeve në shumën prej 2,500,000 lekë ia ka dhënë hua vëllait të saj me interes 3 % dhe për pasojë ka përfituar të ardhura të tjera nga interesat, për periudhën 2005 – 2008.

39.6. Për të provuar deklarimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar, ndër të tjera, si prova: (i) vërtetimin e datës 15.1.2020 lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2020, të DRT-së Shkodër; si dhe (iii) deklaratën noteriale të datës 15.10.2012, me deklarues z. A.P., (vëllai i bashkëshortes).

39.7. Referuar vërtetimit të shoqërisë “****” sh.p.k., znj. K.P., ka qenë punonjëse pranë kësaj shoqërie në pozicionin specialist për shitjen e artikujve të ndryshëm për periudhën 1.10.2000 – 31.8.2004 me pagë bazë mujore *neto* 60,000 lekë, të cilën e ka deklaruar në tatime me dokumentacionin përkatës dhe i është thënë se është me kohë të pjesshme dhe nuk përbën problem. Ndërsa, referuar shkresës së DRT-së Shkodër³² që mban datën 2.3.2020, bazuar në të dhënat e sistemit C@TS subjekti “****” është regjistruar me NIPT *** në DRT-në Shkodër dhe se nuk disponohen të dhëna për pagesën e tatimit në burim nga ky subjekt.

39.8. Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga punësimi në shoqërinë “****” sh.p.k. Nuk provohet që personi i lidhur K.Q., (P.) të ketë qenë e punësuar pranë këtij subjekti tregtar – të ketë qenë e deklaruar si punonjëse në listëpagesat e tij dhe të jenë paguar detyrimet tatimore për të ardhura të mundshme të pretenduara prej saj nga punësimi në këtë shoqëri.

39.9. Për më tepër, nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të QKB-së, pas kërimit në fushën e caktuar me qëllim identifikimin e NIPTI-t të kësaj shoqërie, u konstatua se subjekti tregtar “****” sh.p.k., me NIPT *** nuk është paraqitur në QKB për të plotësuar të dhënat e tij.

40. Gjithashtu, referuar deklaratës noteriale të datës 15.10.2012, vëllai i bashkëshortes së subjektit, z. A., (E.) P., ka deklaruar se për hapjen e aktivitetit ka marrë hua nga e motra, znj.

³⁰ Pyetësori nr. 2/ pyetja 3/ nënpyetjet (i) dhe (ii) dhe kërkesa për depozitim dokumentacioni justifikues ligjor.

³¹ Përgjigjet e pyetjes 3 të pyetësorit nr. 2, -të dërguara me e-mailin e datës 3.3.2020.

³² Shkresë e bërë në përgjigje të kërkesës së depozituar nga personi i lidhur, të protokolluar në DRT-në Shkodër me nr. *** prot., datë 2.3.2020.

K.P., shumën prej 2,500,000 lekësh, me interes 3% në muaj, me afat 1-vjeçar. Po ashtu, ka deklaruar se motra e tij e ka ndihmuar gjatë ushtrimit të aktivitetit, duke ndjekur aktivitetin çdo ditë mbasdite dhe për këtë i ka dhënë pagë në shumën 35,000 lekë. Paga, shpërblymi dhe fitimi nga interesi i çdo viti i është shtuar shumës dhe ka vazhduar për rreth 3 vjet interesi 3%. Pasi e motra u fejuar dhe para martesës është shkëputur nga puna dhe ai i ka dhënë shumën 70,000 euro.

40.1. Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga punësimi në biznesin e vëllait. Nuk provohet që personi i lidhur, znj. K.Q., (P..) të ketë qenë e punësuar pranë këtij subjekti tregtar – të ketë qenë e deklaruar si punonjëse në listpagesat e tij dhe të jenë paguar detyrimet tatimore për të ardhura të mundshme të pretenduara prej saj nga punësimi në këtë biznes. Për më tepër, personi i lidhur pretendon se ka punuar që nga viti 2005 në biznesin e vëllait të saj, ndërkohë që referuar dokumentacionit të administruar në dosje subjekti tregtar “****” është regjistruar në organin tatimor në vitin 2006.

40.2. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se personi i lidhur nuk dokumenton të ardhura të krijuara më parë, duket se nuk ka pasur mundësi t’i japë hua vëllait të saj shumën prej 2,500,000 lekësh – nga e cila pretendon të ardhura të tjera shtesë. Për më tepër, kjo hua dhe të ardhurat e pretenduara prej saj nuk janë deklaruar si burim krijimi i shumës prej 70,000 euro – në deklarinimin fillestar të pasurisë të bërë nga personi i lidhur në vitin 2008.

40.3. Komisioni evidentoi se të ardhurat e përfituara dhe të provuara me dokumentacion justifikues ligjor nga personi i lidhur për periudhën 2004 – 2008³³ (duke konsideruar të plota të ardhurat për vitin 2008) kanë qenë në shumën prej 1,082,478 lekësh.

40.4. Për sa më sipër, duket se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 70,000 euro deri në vitin 2008.

40.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

41. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit³⁴ dhe sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se ka lidhur martesë në shtator të vitit 2008 dhe, si rrjedhojë, bashkëshortja në cilësinë e personit tjetër të lidhur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 ka deklaruar pasurinë që dispononte veçmas si pasuri të saj para martesës dhe se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se fakti i fillimit të bashkëjetesës përkon me datën e martesës.

41.1. Subjekti i qëndron të gjitha shpjegimeve të dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ lidhur me burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 70,000 euro, të deklaruar nga personi i lidhur si gjendje likuiditetesh *cash* në deklarinimin e bërë veçmas në DPV-në e vitit 2008.

41.2. Ashtu sikurse ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për periudhën 1.10.2000 – 31.8.2004, bashkëshortja ka qenë e punësuar te subjekti tregtar “****” sh.p.k. Krahas dokumentacionit të depozituar më parë, subjekti ka depozituar si provë të re dokumentin (shkresë e thjeshtë), kontratë pune të datës 29.9.2000,

³³ Referuar vërtetimeve për të dhënat e punësimit të personit të lidhur Aneks **** në dosjen e ILDKPKI.

³⁴ (i) prapësimet/provat e depozituara në 24.8.2020 –protolluar në Komision nr. **** prot., (ii) prapësimet/provat e dërguara në rrugë elektronike me e-mail datë 25.8.2020; dhe (iii) prapësimet/provat e dërguara në rrugë elektronike me e-mail datë 7.9.2020.

lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k., me administrator z. Gj.P., në cilësinë e punëdhënësit dhe znj. K.P., (Q.), në cilësinë punëmarrësit.

41.3. Të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna e personit të lidhur në shoqërinë “***” sh.p.k., për periudhën 1.10.2000 – 31.8.2004, janë në total në vlerën prej 2,820,000 lekësh.

41.4. Lidhur me deklarimin nga shoqëria “***” sh.p.k., të punonjës K.P., dhe pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga puna e saj, si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga kontakti që ka pasur me këtë subjekt tregtar i është sqaruar se janë paguar të gjitha detyrimet ligjore, por nga komunikimi me financieren e kësaj firme i është thënë se sipas legjislacionit tatimor dokumentet e subjektit tregtar ruhen për një periudhë 5-vjeçare, ndërsa regjistrat e biznesit ruhen maksimumi për një afat 10-vjeçar.

41.5. Gjithsesi, subjekti ka mbajtur qëndrimin se referuar legjislacionit shqiptar në fuqi punëdhënësi ka detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e tatimit dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punëmarrësit.

41.6. Në vijim, subjekti ka pretenduar se nga shuma e të ardhurave që ka përfituar personi i lidhur (bashkëshortja) në shoqërinë “***” sh.p.k., vlerën prej 2,500,000 lekësh – në vitin 2005 ia ka dhënë hua me inters 3 % në muaj (36 % në vit) vëllait të saj, z. E.P., me qëllim financimin e biznesit, duke justifikuar vlerën e lartë të interesit me faktin se bashkëshortja në një farë kuptimi ishte ortak e “fshetur” në biznesin e regjistruar në emrin e vëllait të saj.

41.7. Pra, subjekti ka pretenduar se për periudhën mars 2005 – gusht 2008 bashkëshortja ka përfituar në formë interesi (*deklaruar ndryshe si përqindje e fitimit nga biznesi*) në total shumën prej 4,393,800 lekësh.

41.8. Gjithashtu, sikurse ka deklaruar gjatë hetimit administrativ subjekti ka pretenduar se bashkëshortja për periudhën mars 2005 – gusht 2008 ka punuar në biznesin e vëllait dhe se të ardhurat totale të përfituara nga paga për këtë periudhë kanë qenë në vlerën prej 1,400,000 lekësh. Për të provuar pretendimet e tij, krahas dokumentacionit të depozituar më parë, subjekti ka depozituar si provë të re dokumentin (shkresë e thjeshtë), “Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 1.3.2005, nënshkruar nga z. E.P., dhe znj. K.P., në prani të avokatit z. I.I.

41.9. Lidhur me deklarimin nga personi fizik “E.P.” të punonjës K.P., dhe pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga puna e saj, si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim të referuar më sipër – që lidhet me marrëdhënien e punësimit të shoqëria “***” sh.p.k.

50. Në lidhje me situatën financiare të bashkëshortes para martesë, subjekti pretendon se ajo ka shfaqur vullnetin e saj, me aktmarrëveshjen paramartesore të datës 2.8.2008, të konfirmuar para noterit publik në datën 6.8.2008, duke deklaruar faktin se këto pasuri të fituara para martesë do jenë ndara përgjithmonë nga pasuria bashkëshortore.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

51. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të shoqëria “***” sh.p.k., të pretenduar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, Komisioni vëren se me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të pretenduara nga punësimi në këtë shoqëri.

51.1. Gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetimin nga shoqëria

“****” sh.p.k., i datës 15.1.2020; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 2.3.2020 e DRT-së Shkodër; dhe (iii) kontratë individuale pune e datës 29.9.2000.

51.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se nuk konfirmohet marrëdhënia e punësimit dhe, si rrjedhim, pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse për të ardhurat e pretenduara nga punësimi. Nga analizimi i shkresës së DRT-së Shkodër, depozituar si provë nga subjekti, duket se përgjigjja e kësaj drejtorie i referohet pagesës së tatimit në burim nga subjekti “****” me Nipt *** (informacion për të cilin nuk disponon të dhëna), sipas kërkesës së bërë nga personi i lidhur, znj. K.P.

51.3. Pra, Komisioni vlerëson se duken të pabazuara pretendimet e subjektit se ka qenë në pamundësi për të disponuar dokumentacion provues lidhur me të dhënat e punësimit të bashkëshortes së tij – pretendim i bërë referuar shkresës së DRT-së Shkodër dhe informacionit të marrë në rrugë verbale nga përfaqësuesit e subjektit, sipas të cilëve nuk kanë ruajtur dokumentacion për kohën.

51.4. Në këtë kuptim, kërkesa për Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër duhej bërë për të siguruar informacion mbi të dhënat e punësimit të personit të lidhur, znj. K.P., (Q.) – deklarimin e saj si punonjëse e këtij subjekti dhe pagesën e tatimit “të mbajtur në burim” për të ardhurat nga paga e saj apo për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe jo kërkesë për pagesën e tatimit në burim nga subjekti tregtar.

51.5. Gjithsesi, Komisioni vlerëson se në zbatim të legjislacionit në fuqi për kohën, listëpagesat e depozitura nga subjektet tregtare në drejtorinë rajonale tatimore me të dhënat e punësimit (paga *bruto*, *neto*, pagesat e tatimit mbi të ardhurat dhe pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dërgoheshin në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, të cilat mbanin evidenca për dokumentimin e marrëdhënies së punës dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të vlerësuar vitet e punës dhe llogaritur masën e pensionit të mundshëm në të ardhmen për çdo punëmarrës.

51.6. Komisioni vëren se subjekti nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor nga DRSSh-ja Shkodër për të dokumentuar marrëdhënien e punësimit të pretenduar të bashkëshortes së tij për periudhën tetor 2000 – gusht 2004 (të ardhurat e përfituara nga paga për këtë periudhë) dhe nuk vërehet përpjekje e tij për të siguruar këtë informacion.

51.7. Komisioni çmon se pretendimet e subjektit lidhur me marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së tij të subjekti “****” sh.p.k. janë kontradiktore, pasi, megjithëse pretendon pamundësi në sigurimin e dokumentacionit provues, nga ana tjetër mban qëndrimin se ka qenë detyrim i kësaj shoqërie për të mbajtur tatimet/kontributet që lidhen me punësimin e znj. K.P., (Q.) dhe kryerjen e pagesave përkatëse të detyrimeve.

51.8. Për më tepër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë pasur dijeni të plotë se nuk ka ekzistuar marrëdhënie e formalizuar punësimi mes subjektit “****” (*** sh.p.k.) dhe znj. K.P., (Qafa), kjo pasi:

- a. në deklaratë personi i lidhur ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga paga e marrë gjatë periudhës së studimeve në universitet nga viti 2000 deri në vitin 2004, punuar pa dokumente;
- b. në deklarimin e bërë veçmas në DPV-në e vitit 2008, vërehet se personi i lidhur, ndër të tjera, ka deklaruar se për periudhën 2000 – 2004 ka punuar si shitëse pa dokumente të shoqëria “****” – Shkodër;
- c. në deklarimin e bërë në datën 26.5.2014 para prokurorit A. G., si person që tregon rrethanat e hetimit – në kuadër të procedimit penal nr. ***³⁵, znj. K. Q., ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] Pasurinë e luajtshme mjete monetare të krijuar nga viti 2000 deri në vitin 2004, kur kam qenë studente dhe nuk kam mbajtur dokumente, por kam punuar në firmën e Gj.

³⁵ Dosja e procedimit penal e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme.

P., pasi e kisha kushëri të largët, i cili është larguar nga Shqipëria që në vitin 2005. Gjatë punës sime pranë këtij biznesi unë nuk kam mbajtur dokumente, pasi kemi rënë dakord para se të filloja punë aty, mbajtja e dokumenteve nuk më ka interesuar dhe se marrëveshja e punës me pronarin e biznesit ka qenë e këtillë. Ai më ka thënë se nuk do ta përfshijë në rregulla të siguracionit, me qëllim për të më paguar me pagë më të lartë [...]”;

- d. në deklaratimet e dhëna para ILDKPKI-së³⁶, e pyetur lidhur me marrëdhënien e punësimit pranë subjektit “***” sh.p.k., personi i lidhur ka deklaruar se ka punuar në Shkodër te ky subjekt duke realizuar të ardhura, por nuk ka depozituar dokumentacion justifikues.

51.9. Në dritën e këtyre fakteve duket se dokumenti “kontratë individuale pune” e datës 29.9.2000 (lidhur ndërmjet znj. K.P., dhe shoqërisë “***” sh.p.k.), depozituar nga subjekti si provë e re me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit nuk ka ekzistuar më parë dhe se Komisioni ngre dyshime të arsyshme se ky dokument është krijuar së fundmi dhe, si i tillë, nuk mund të marrë vlerën e provës në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile.

60. Në të kundërt, ky dokument do të depozitohet si dokumentacion provues gjatë hetimit administrativ të kyer nga ILDKPKI-ja, hetimit penal të zhvilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁷, si edhe si dokumentacion shoqërues i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

61. Duke marrë në konsideratë faktin se kjo marrëdhënie punësimi është deklaruar si e krijuar disa vite para se subjekti i rivlerësimit të lidhte martesë me znj. K.P., (Q.), si edhe faktin se të ardhurat e pretenduara nga paga kanë shërbyer në vijim si burim mbi bazën e të cilave janë krijuar të ardhura të tjera, të cilat pretendohet se kanë mundësuar krijimin e shumës prej 70,000 euro *cash* nga bashkëshortja e tij, trupi gjykues çmon si shumë të rëndësishme analizimin dhe verifikimin e situatës faktike lidhur me mundësinë e punësimit – duke vlerësuar me objektivitet çdo të dhënë dhe *indicie* lidhur me këtë marrëdhënie dhe, si rrjedhojë, mundësinë e krijimit të të ardhurave të pretenduara nga personi i lidhur.

62. Në këtë këndvështrim, Komisioni çmon se një e dhënë e rëndësishme për t’u analizuar, krahas dokumentacionit provues lidhur me marrëdhënien e punësimit – analizuar si më sipër, janë deklaratimet e bëra nga subjekti/personi i lidhur për të ardhurat e përfituara – në vlerësim objektiv të punës së kryer, kohëzgjatjes së saj dhe kualifikimit që kërkonte kryerja e kësaj pune.

63. Siç u evidentua më sipër, gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura si shitëse *part-time* në dyqan rrobash, pagën *neto* mujore prej 60,000 lekësh.

64. Nga analiza objektive e kësaj të dhëne, Komisioni vlerëson se nuk duket bindës deklarimi i bërë për pagën *neto* të përfituar prej 60,000 lekësh/muaj për një punë të kryer me kohë të pjesshme, për periudhën kur pretendohet se është kryer (vitet 2000 – 2004) dhe për të cilën nuk nevojitej kualifikim profesional/arsimor i caktuar.

65. Në këtë kuptim, për analogji, Komisioni verifikoi/analizoi pagat *neto* të përfituara nga subjekti i rivlerësimit për të njëjtën periudhë, i cili në atë kohë ushtronte funksionin e gjyqtarit dhe duket se paga mesatare *neto* e tij për këto vite ka qenë rreth 48,000 lekë/muaj (për vitin 2000 paga mesatare rreth 33,000 lekë/muaj; për vitin 2001 paga mesatare rreth 38,000 lekë/muaj; për vitin 2002 paga mesatare rreth 40,800 lekë/muaj; për vitin 2003 paga mesatare rreth 54,000 lekë/muaj; dhe për vitin 2004 paga mesatare rreth 74,400 lekë/muaj). Pra, duket se paga *neto* mujore e pretenduar si e përfituar nga marrëdhënia e punësimit e personit të lidhur për vitet 2000 – 2004, nuk i përgjigjet nivelit të pagave për këtë periudhë – duke marrë në konsideratë profilin dhe orët e punës.

³⁶ Procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive” të datës 17.10.2012 - të mbajtur në ILDKPKI, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2020.

³⁷ Procedim penal i nisur ndaj subjektit të rivlerësimit – mbi bazën e kallëzimit të bërë nga ILDKPKI-ja.

66. Për më tepër, nuk përputhen deklaratimet e bëra më parë nga personi i lidhur në ILDKPKI për pagën *neto* të përfitur nga puna në shoqërinë “****” sh.p.k., me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

67. Komisioni vëren se në deklarinimin fillestar të pasurisë së bërë veçmas nga personi i lidhur (DPV-në e vitit 2008) është deklaruar puna në shoqërinë “****” sh.p.k., me pagë mujore prej 35,000 lekësh të reja. Gjithashtu, në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarinimit të pasurive” të datës 17.10.2012 - të mbajtur në ILDKPKI, i pyetur lidhur me marrëdhënien e punësimit të shoqëria “****” sh.p.k., dhe të ardhurat e përfituara, personi i lidhur, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] kam punuar në Shkodër dhe nga kjo punë me pagë 35,000 lekë/muaj dhe të ardhura të tjera të këtyre viteve të kursyera kanë qenë 2,500,000 lekë [...]”.

68. Për sa më sipër, nga analiza e të gjitha provave të administruara në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar marrëdhënien e punësimit të personit të lidhur dhe të ardhura të mundshme të përfituara në shoqërinë “****” sh.p.k.

68.1. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë kryer deklarinim të pamjaftueshëm për të ardhurat e pretenduara nga punësimi në shoqërinë “**” sh.p.k.**

69. Nisur nga konkluzioni i mësipërm, Komisioni çmon si të pabazuara pretendimet e subjektit se bashkëshortja e tij nga puna e kryer në shoqërinë “****” sh.p.k. ka kursyer shumën prej 2,500,000 lekësh dhe se këtë shumë ia ka dhënë vëllait të saj hua me interes 36 % në vit, duke përfutur totalin e interesave në shumën prej 4,393,800 lekësh.

70. Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar marrëdhënien e punësimit të subjekti “E.P.,” person fizik dhe të ardhurat e pretenduara nga puna e kryer në këtë subjekt. Për më tepër, vërehet se në deklaratimet e dhëna në datën 26.5.2014 para prokurorit A.G., si person që tregon rrethanat e hetimit – në kuadër të procedimit penal nr. ***³⁸, znj. K.Q., ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] gjatë punës sime pranë biznesit të vëllait nuk kam qenë e siguruar sepse isha e punësuar në shtet dhe paguaja sigurimet sipas ligjit [...]”.

70.1. Komisioni vëren mospërputhje në deklaratimet e bëra nga personi i lidhur – për të ardhurat e përfituara nga marrëdhëniet e pretenduar e bashkëpunimit në biznes me vëllain e saj dhe e punësimit në subjektin “E.P.,” Person Fizik.

70.2. Në deklarinimin fillestar të pasurisë, të bërë veçmas në vitin 2008, personi i lidhur, ndër të tjera, në rubrikën e të ardhurave ka deklaruar se: “... për vitet 2005 – 2008 kam punuar *part-time* pasdite si bashkëpronare me personin fizik në emër të vëllait, E.P., dhe se ka përfutur të ardhura në total në shumën prej 30,000 euro”. Ndërkohë, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bashkëshortja e tij nga marrëdhëniet e “bashkëpunimit në biznes” me vëllain e saj ka përfutur në total shumën prej 4,393,800 lekësh si interesa huaje (deklaruar ndryshe si pjesë fitimi), si edhe vlerën prej 1,400,000 lekësh si të ardhura nga paga, pra, në total shumën prej 5,793,800 lekësh. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ³⁹ subjekti ka deklaruar se të ardhurat e përfituara si pagë nga bashkëshortja e tij, nga puna *part-time* në biznesin e vëllait për periudhën mars 2005 – shtator 2008 janë në vlerën prej 1,575,000 lekësh.

³⁸ Dosja e procedimit penal e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁹ Në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

70.3. Një tjetër mospërputhje në deklaratimet e bëra ka të bëjë me huan e pretenduar si të dhënë vëllait të personit të lidhur, kohëzgjatjen e saj dhe, si rrjedhim, shumën totale të përfituar nga interesat.

70.4. Në deklaratën “Vetting” personi i lidhur ka deklaruar se huaja e dhënë për vëllanë e saj është 1-vjeçare, e dhënë për vitet 2005 – 2006. Konstatohet se pjesë e dokumentacionit shoqërues të deklaratës “Vetting” – (Aneks ***) gjendet deklarata noteriale⁴⁰ e datës 15.10.2012, e vëllait të personit të lidhur, z. E. P., në referim të së cilës, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] për hapjen e aktivitetit unë kam marrë hua nga motra ime K.P., shumën 2,500,000 lekë me interes 3 % në muaj, për një afat 1 vit... [...] Gjithashtu, motra ime më ka ndihmuar gjatë ushtrimit të aktivitetit tim, duke ndjekur aktivitetin çdo ditë mbasdite dhe, për këtë, unë i kam dhënë edhe një pagë prej 35,000 lekësh/muaj. Paga, shpërblimet dhe fitimi nga interesi i çdo viti i është shtuar shumës dhe ka vazhduar për rreth 3 vjet interesi 3 % [...]”.

70.5. Duket se deklarata noteriale e vëllait të subjektit të rivlerësimit ka paraprirë deklarin e bërë nga personi i lidhur në ILDKPKI në datën 17.10.2012, nga ku referuar procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, personi i lidhur, znj. K.P., (Q.), ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] Kam punuar në Shkodër dhe nga kjo punë me pagë 35,000 lekë/muaj dhe të ardhura të tjera të këtyre viteve të kursyera kanë qenë 2,500,000 lekë. Këtë shumë i kam dhënë vëllait me interes 3 % në muaj për një vit pa dokumente, e cila ka vazhduar për 3 vite [...]”.

70.6. Gjithashtu, në deklarin e bërë para organit të akuzës në datën 26.5.2014, personi i lidhur ka përmendur faktin e dhënies së huas në shumën prej 2,500,000 lekësh vëllait të saj, për të cilën shpjegon se e provon me deklaratën noteriale të datës 15.10.2012 – të bërë nga vëllai i saj.

70.7 Komisioni vëren se megjithëse personi i lidhur ka deklaruar se huaja e dhënë vëllait ka qenë e paformalizuar, me dërgimin e prapësimeve subjekti ka paraqitur si provë të re dokumentin “aktmarrëveshje - bashkëpunim” i datës 1.3.2005, të lidhur mes shtetasve K.P., dhe E.P., në prani të avokatit I.I., ku parashikohet edhe fakti i huadhënies së shumës prej 2,500,000 lekësh.

70.8 Pa i hyrë vlerësimit të përmbajtjes së këtij dokumenti, krahas faktit se personi i lidhur ka deklaruar më parë se i ka dhënë hua vëllait të saj pa dokument, si edhe faktit se ky dokument nuk është paraqitur/depozituar më parë si dokumentacion provues gjatë hetimit administrativ të kyer nga ILDKPKI-ja, hetimit penal të zhvilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁴¹, si edhe si dokumentacion shoqërues i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, Komisioni krijoi bindjen se ka të bëjë me një dokument të krijuar/prodhuar së fundmi, pasi megjithëse pretendohet se marrëveshja midis palëve është lidhur më 1.3.2005, në të është pasqyruar nipti i avokatit I.I., (NIPTI ***), i cili pas verifikimive të bëra në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se data e regjistrimit të këtij NIPTI është 6.6.2016. Pra, del qartë fakti se kjo marrëveshje në rastin më të mirë është përpiluar pas datës 6.6.2016, datë në të cilën avokati I.I., është pajisur me niptin e referuar në aktmarrëveshje.

70.9 Gjithashtu, konstatohet se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për qarkullimin e realizuar dhe fitimin *neto* nga subjekti “E.P.,” person fizik për këtë periudhë, si edhe pagesën e detyrimeve tatimore nga personi i lidhur për të ardhurat e deklaruara të përfituara si interesa nga huaja apo në formën e fitimit nga “aktiviteti tregtar i përbashkët i pretenduar me vëllanë”.

71. Nga analiza e të gjitha provave të administruara në dosje konstatohet se personi i lidhur nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën prej

⁴⁰ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2012.

⁴¹ Procedim penal i nisur ndaj subjektit të rivlerësimit – mbi bazën e kallëzimit të bërë nga ILDKPKI-ja.

2,500,000 lekësh për vëllanë e saj. Gjithashtu, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar marrëdhënien e pretenduar të kësaj huaje apo marrëdhënien e bashkëpunimit në biznes me vëllanë e saj (si individ/person fizik), si edhe për të ardhurat e pretenduara nga punësimi në këtë aktivitet.

71.1. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë kryer deklaram të rremë dhe të pamjaftueshëm për të ardhurat e pretenduara si interesa huaje apo nga zhvillimi i aktivitetit tregtar, të regjistruar në emër të vëllait të personit të lidhur, me qëllim gjenerimin fiktiv të të ardhurave monetare.

71.2. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si edhe vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë së krijimit të shumës prej 70,000 euro – pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2

Analiza financiare e personit të lidhur deri më 31.12.2008	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga pagat e personit të lidhur	1,082,478
Total të ardhurat	1,082,478
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së ⁴²	605,626
Total shpenzime	605,626
Likuiditet gjendje <i>cash</i> /konvertuar shuma 70,000 euro ⁴³	8,966,300
Total pasuri	8,966,300
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	- 8,489,448

71.3. Për sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 70,000 euro deri në vitin 2008.

72. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 familjarët e bashkëshortes së subjektit (nisur nga deklarimi i bërë nga personi i lidhur në deklaratën fillestare të pasurisë dhe në deklaratën “Vetting” bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të familjarëve të saj, të cilat kanë krijuar shumën prej 10,000 euro të deklaruar si dhuratë në deklaratën para fillimit të detyrës.

72.1. Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të deklarojë burimin e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, të cilat kanë shërbyer si kontribut për dhurimin e shumës prej 10,000 euro në favor të bashkëshortes së tij, shumë kjo e deklaruar prej saj në deklaratën fillestare të bërë në ILDKPKI, si personi i lidhur⁴⁴.

72.2. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë e dhuruar ka si burim të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i vëllait, si dhe të ardhurat nga puna e nënës dhe e motrës së bashkëshortes.

⁴² Të llogarituar sipas ILDKPKI-së për 1 (një) person për periudhën 2004 – 2008.

⁴³ Konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitet 2000 – 2008.

⁴⁴ Pyetja nr. 2/Pyetësi nr. 2.

72.3. Për të provuar deklaratimet e tij, ndër të tjera, subjekti ka depozituar si prova: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.10.2012, të shtetasit A., (E.) P.; (ii) certifikatë të regjistrimit në organin tatimor të vitit 2006 për z. E.P., dhe vendim nr. ***, datë 2.3.2006 për regjistrimin e shtetasit E.P., si person fizik me aktivitet “tregtim artikuj industrialë”; (iii) deklaratë noteriale nr. ***, të datës 25.1.2017, të shtetasve M.P., dhe D.P.; si dhe (iv) vërtetimin nr. *** prot., datë 2.3.2020 të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë.

72.4. Konstatohet se nga analiza e dokumentacionit të depozituar lidhur me aktivitetin tregtar të subjektit “E.P.” nuk evidentohen të ardhura të realizuara, fitim i deklaruar/realizuar dhe as pagesë e detyrimeve tatimore në DRT Lezhë. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të QKB-së, pas kërkimit në fushën e caktuar të niptit të subjektit tregtar “E.P.” rezulton se ai nuk është paraqitur në QKB për të plotësuar të dhënat e tij.

72.5. Nëpërmjet dy dokumenteve noteriale të sipërcituara evidentohet se në mënyrë deklarative vëllai, nëna dhe motra e subjektit pretendojnë se si familje i kanë dhuruar personit të lidhur me rastin e martesës shumë prej 10,000 euro.

72.6. Ndërsa vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë evidenton faktin se znj. D. Gj. L., (P.) punon si mësuese prej datës 17.9.2001 – deri në datën e lëshimit të vërtetimit, por se nuk referon të dhëna për të ardhurat e përfituara prej saj nga punësimi.

72.7. Për sa më sipër, referuar deklaratimeve të bëra nga subjekti, si dhe dokumentacionit të depozituar prej tij duket se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimin e shumës prej 10,000 euro - deri në vitin 2008, në favor të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

72.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi i prapësimeve

73. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues⁴⁵ për të ardhurat nga punësimi i motrës së bashkëshortes së tij, znj. D.L. (P.) dhe bashkëshortit të saj. Por, subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhura të mundshme të përfituara nga prindërit e bashkëshortes së tij, ndërsa lidhur me të ardhurat e vëllait të bashkëshortes nga aktiviteti tregtar – sikurse është evidentuar, subjekti ka depozituar vetëm dokumentacion mbi regjistrimin e këtij subjekti. Nuk është depozituar dokumentacion lidhur me qarkullimin dhe fitimin e realizuar nga subjekti tregtar “E.P.” person fizik, si edhe pagesën e detyrimeve tatimore.

73.1. Komisioni vëren se, në asnjë rast, subjekti nuk ka deklaruar kontributin konkret (pjesën takuese të dhuruar) të familjarëve të bashkëshortes së tij – në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, i cili ka shërbyer për krijimin e shumës prej 10,000 euro.

73.2. Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi prapësimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet financiare të prindërve të bashkëshortes dhe vëllait të saj, çmon se janë të karakterit deklarativ - dhe nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor.

73.4. Ndërsa, nga analiza e dokumentacionit të depozituar për të ardhurat nga punësimi i të motrës së bashkëshortes së tij, znj. D.L., duket se të ardhurat totale *neto* nga paga e personit tjetër të lidhur për vitet 2001 – 2007 janë si vijon: (i) për vitin 2001 rreth 42,000 lekë; (ii) për vitin 2002 rreth 154,000; (iii) për vitin 2003 rreth 177,000; (iv) për vitin 2004 rreth 171,000 lekë; (v) për vitin 2005 rreth 249,000 lekë; (vi) për vitin 2006 rreth 292,000 lekë; dhe (vii) për

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 10.8.2020, të Bashkisë Lezhë – ku pasqyrohet baza e vlerësueshme e pagës për punëmarrësin D.L.

vitin 2007 rreth 360,000 lekë. Ndërsa për 6-mujorin e parë të vitit 2008, të ardhurat totale *neto* të përfituara nga paga e personit tjetër të lidhur janë rreth 182,000 lekë.

73.5. Komisioni vëren se të ardhurat vjetore të përfituara nga personi tjetër i lidhur janë modeste, të cilat vlerësohen se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të familjes së saj. Në total, të ardhurat *neto* të kësaj shtetaseje për vitet 2001 – qershor 2008⁴⁶ janë në vlerën prej 1,629,260 lekësh. Për të mbuluar shumën prej 10,000 euro (konvertuar me kursin e kohës në shumën prej 1,231,800 lekë), personi tjetër i lidhur do duhej t'i dhuronte personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) rreth 76 % të të ardhurave të saj.

73.5. Nga analiza përfundimtare e të dhënave të mësipërme, dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ dhe me prapësimet e dërguara pas njohjes me rezultatet e hetimit, Komisioni krijoi bindjen se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimin e shumës prej 10,000 euro - deri në vitin 2008, në favor të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

73.6. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 10,000 euro – deklaruar si e dhuruar nga familjarët e personit të lidhur.

Qëndrimi i subjektit për pasuritë e krijuara nga personi i lidhur para martesë

74. Krahas shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat dhe pasuritë e krijuara dhe të deklaruara nga bashkëshortja e tij para martesë – të analizuar si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bashkëshortja e tij ka shfaqur vullnetin e saj, me aktmarrëveshjen paramartesore të datës 2.8.2008, të konfirmuar para noterit publik në datën 6.8.2008, duke deklaruar faktin se pasuritë e saj të fituara para martesë do jenë të ndara përgjithmonë nga pasuria bashkëshortore.

74.1. Gjithashtu, në prapësimet e dërguara subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është deklaruar gjithmonë si pasuri e ndarë në deklaratat e pasurisë dhe se sipas përcaktimeve që bën Kodi i Familjes për pasurinë bashkëshortore nuk konsiderohen pasuri bashkëshortore. Konkretisht, neni 74 i Kodit të Familjes përcakton përbërjen e bashkësisë gjatë martesës.

74.2. Referuar dokumentit “aktmarrëveshje paramartesore” të datës 2.8.2008 (konfirmuar me aktin noterial vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.8.2008) – të depozituar nga subjekti si provë e re pas kalimit të barrës së provës dhe dërgimit të rezultateve të hetimit rezultojnë se shtetasit *K.P.*, dhe *Arjan Qafa* kanë rënë dakord të lidhin martesë ligjore në datën 29.8.2008, sipas datës së caktuar nga zyra e gjendjes civile. Para se të lidhin këtë martesë ligjore me vullnet të plotë redaktojnë këtë aktmarrëveshje për të përcaktuar dhe saktësuar të drejtat dhe detyrimet pasurore të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, të kandidatëve për bashkëshort, përfshirë dhe të ardhurat financiare. Në vijim, në këtë aktmarrëveshje përcaktohet se të ardhurat e përfituara nga znj. *K.P.*, gjatë punësimit pranë subjektit tregtar firma ‘***’ për periudhën 1.10.2000 deri më 31.8.2004 dhe të ardhura e fituara nga marsi i vitit 2005 deri në gusht të vitit 2008, nga punësimi në formë ortakërie pranë biznesit të vëllait të saj bashkë me interesat dhe të ardhurat e tjera që kapin vlerën 70,000 euro, do të jenë pronë vetjake e shtetasit *K.P.*, dhe se kjo shumë do administrohet prej saj, e veçuar nga pasuria bashkëshortore. Këto të ardhura të realizuara nga znj. *K.P.*, para lidhjes së martesës do të administrohen të ndara përgjithmonë nga pasuria bashkëshortore. Në vijim deklarohen dhe bien dakord se këto të ardhura do të deklarohen të veçuara edhe në deklaratat periodike vjetore dhe se z. *Arjan Qafa* (bashkëshorti i ardhshëm) nuk do të ketë asnjë të drejtë dhe detyrim mbi pasuritë e znj. *K.P.*, pasuri të vëna para martesë të cilat do jenë të veçuara.

⁴⁶ 1 muaj para lidhjes së martesës së personit të lidhur.

Analiza ligjore e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

75. Referuar nenit 66 të Kodit të Familjes, *regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës.*

75.1. Sipas nenit 73 “*Bashkësia ligjore*”, *regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor.*

75.2. Neni 74 i Kodit të Familjes përcakton se bashkësia përbëhet nga: “*(a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; (b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; (c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; (ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës. Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës derjtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit*”.

75.3. Ndërsa në nenin 77 të këtij Kodi përcaktohet se pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: “*(a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi; (b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë; c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesorë të pasurisë vetjake; ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare; d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë; dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura; e) shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes*”.

75.4. Gjithashtu, në nenin 69 të Kodit të Familjes përcaktohet se *kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose përfaqësuesve të tyre. Në çastin e nënshkrimit të kontratës, noteri i lëshon palëve një akt noterial, i cili përmban identitetin e plotë, adresën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe datën e lidhjes së kontratës. Noteri ka detyrimin të depozitohet kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës. Në qoftë se në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.*

75.5. Nga analiza e dokumentit aktmarrëveshje paramartesore të depozituar nga subjekti si provë e re pas dërgimit të rezultateve të hetimit, duket se ajo nuk përmban elementët e përcaktuar nga Kodi i Familjes për formën e kontratës martesore. Gjithashtu, nuk u provua që ky akt të jetë depozituar në zyrën e gjendjes civile.

75.6. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore ndër të tjera, ka deklaruar se *në këtë aktmarrëveshje kanë përcaktuar detyrimet reciproke, kanë përcaktuar jo vetëm pasuritë, kanë përcaktuar dhe të drejtat, pasi në datën 29.8.2008 kanë lidhur martesë dhe në martesë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet, pra në qoftë se do kishte bërë një kontratë paramartesore në referim të ligjit do kishte detyrimin ta paraqiste pranë zyrës së gjendjes civile. Aktmarrëveshja është bërë me qëllim mospasjen e konflikteve në familje lidhur me pjesën pasurore të luajtshme dhe të paluajtshme, e cila është e ndarë që në krye të herës.*

75.7. Komisioni vlerëson se në këtë proces merr rëndësi verifikimi i ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive, qoftë edhe i pasurive të krijuara para martese nga personi i lidhur – të

vlerësuara këto, sigurisht, në mënyrë objektive dhe proporcionale në harmoni me provat dhe shpjegimet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në raport të tillë që të krijojnë bindjen e trupit gjykues se pasqyrojnë fakte të vërteta, nisur edhe nga funksioni specifik që kanë mbajtur subjektet e rivlerësimit.

75.8. Parë në këtë këndvështrim, nuk është e qartë se çfarë kërkon të provojë subjekti i rivlerësimit me depozitim të dokumentit “aktmarrëveshje paramartesore”.

75.9. Gjithsesi, edhe në kushtet e trajtimit të pasurisë paramartesore si pasuri vetjake, pasuri kjo e deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash*, Komisioni vëren se në krijimin e pasurive të ardhshme pas lidhjes së martesës (pasuri të cilat do të trajtohen në vijim të këtij vendimi) nuk është përcaktuar specifikisht burimi i krijimit të tyre – në mënyrë të tillë që të kemi ndarje të qartë se cilat janë pasuritë e pretenduara si aksesore të pasurisë vetjake (pasuri e përdorimit ngushtësisht vetjak), sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Familjes.

76. Për më tepër, rezulton se në deklaratimet e dhëna në datën 26.5.2014 para prokurorit A. G., në cilësinë e personit që tregon rrethanat e hetimit, personi i lidhur, ndër të tjera, ka deklaruar se: “ [...] *para martese me shtetasin Arjan Qafa ne kemi diskutuar rreth pasurisë së krijuar para martese dhe kemi rënë dakord që pasuria e fituar para martese do jetë e ndarë nga pasuria e fituar pas martese, marrëveshje verbale kjo e pashkruar, por e konfirmuar pasi unë të ardhurat e mia i menaxhoj vetë [...]*”.

76.1. Në dritën e këtij fakti të rëndësishëm të deklaruar nga personi i lidhur – “si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit” në funksion të procedimit penal të nisur ndaj bashkëshortit të saj për veprën penale “refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal duket se dokumenti “aktmarrëveshje paramartesore” i datës 2.8.2008 nuk ka ekzistuar më parë dhe se Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se ky dokument është krijuar së fundmi dhe, si i tillë, nuk mund të marrë vlerën e provës në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile.

76.2. Për sa më sipër, në kushtet kur pasuria e pretenduar si e krijuar para martese nga personi i lidhur është deklaruar në formën e likuiditeteve *cash*, pra, është pasuri e pamaterializuar/trupëzuar dhe e paevidentuar më parë në institucione financiare, si edhe nisur nga analiza e kryer për burimin e deklaruar të krijimit të saj – në vlerësim edhe të provave të dyshimta të depozituara nga subjekti, trupi gjykues krijoi bindjen se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën prej 80,000 euro, madje ngrihen dyshime të arsyeshme se kjo pasuri është deklaruar fiktivisht - me dijeninë e plotë të subjektit të rivlerësimit, me qëllim mbulimin e burimit financiar të vërtetë të krijimit të pasurive që do të bliheshin/krijoheshin në të ardhmen.

Huat e dhëna nga personi i lidhur

77. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ u konstatua se në vazhdimësi personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka dhënë hua me interes shuma në vlera të konsiderueshme, të cilat si burim kanë pasuritë në formë likuiditetesh *cash* të deklaruara prej saj në deklaratimin fillestar të pasurisë. Të renditura sipas viteve (periudhave të zgjatjes së tyre) duke pasqyruar shumën e principalit (shumën e dhënë hua), huamarrësin dhe interesin e përfituar, këto kontrata janë si vijon:

- i. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2009, sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetasit S.V., shumën prej 5,000,000 lekësh, me afat 1-vjeçar (31.1.2009 – 30.1.2010), me interes 1.5 %/muaj ose 75,000 lekë. Të ardhurat nga interesat janë në total në shumën 900,000 lekë;
- ii. kontratë huaje nr. *** rep., nr. 26 kol., datë 23.1.2010, sipas së cilës znj. K. Q., i jep hua shtetasit S.V., shumën prej 5,000,000 lekësh, me afat 1-vjeçar (31.1.2010 –

- 30.1.2011), me interes 1.5 % /muaj ose 75,000 lekë. Të ardhurat nga interesat janë në total në shumën 900,000 lekë;
- iii. kontratë huaje nr. *** rep., nr. 130 kol., datë 5.2.2011, sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetasit S.V., shumën prej 5,000,000 lekësh, me afat 1-vjeçar (1.2.2011 – 31.1.2012), me interes 2 % /muaj ose 100,000 lekë. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 1,200,000 lekë;
 - iv. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.2.2012, sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetasit S.V., shumën prej 5,000,000 lekë, me afat 1-vjeçar (1.2.2012 – 31.1.2013), me interes 2.5 %/muaj ose 125,000 lekë. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 1,500,000 lekë;
 - v. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.6.2012, sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetas E.Z., (M.) shumën 10,000 euro, me afat 2 muaj (21.6.2012 – 20.8.2012), interes 5 % ose 1,000 euro gjithsej. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 1,000 euro;
 - vi. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.8.2012 sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetas E.Z., (M.) shumën prej 13,000 euro, me afat 6 muaj (25.8.2012 – 25.2.2013), interes i pritshëm në vlerën 3,650 euro gjithsej. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 3,650 euro;
 - vii. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2013 sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetasit S.V., shumën prej 5,000,000 lekësh, me afat 1-vjeçar (18.1.2013 – 18.1.2014), me interes 2 % /muaj ose 100,000 lekë. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 1,500,000 lekë;
 - viii. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2013 sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetas E.Z., (M.) shumën prej 17,500 euro, me afat 6 muaj (20.1.2013 – 20.7.2013), pa interes (sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.9.2013, huadhënësja K.Q., deklaroi se shtetasja E.Z., (M.) e ka likuiduar shumën e marrë hua);
 - ix. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.7.2013 sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetas E.Z., (M.) shumën prej 20,000 euro, me afat 2-mujor (21.7.2013 – 20.9.2013), me interes 2,000 euro. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 2,000 euro;
 - x. kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2015, sipas së cilës znj. K.Q., i jep hua shtetasit S.V., shumën prej 3,500,000 lekë, me afat 1-vjeçar (10.3.2015 - 10.3.2016), me interes 200 euro/muaj. Të ardhurat e përfituara nga interesat janë në total në shumën 2,400 euro.

77.1. Të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. K. Q., të pretenduara si të përfituara nga interesat e huave të dhëna prej saj, rezultojnë të jenë në total në shumën 6,240,000 lekë + 9,050 euro.

77.2. Konstatimet e ILDKPKI-së lidhur me këto të ardhura të pretenduara

- 1) Fshehje e kontratave të tjera të huadhënies, pasi, referuar deklaratës së interesave private të vitit 2012 dhe përgjigjes së DPPPP-së janë gjetur edhe 2 kontrata huadhënieje, konkretisht, të shumës 13,000 euro, me interes 3,650 euro me afat periudhën 25.8.2012 – 25.2.2013, si dhe të shumës 20,000 euro, me interes 2,000 euro, me afat periudhën 21.7.2013 – 20.9.2013 me shtetasen E.Z. (M).
- 2) Referuar kontratave të huas dhe përgjigjes së ardhur nga DRT-ja Tiranë, rezultoi se asnjë nga palët (huamarrëse/huadhënëse) nuk kanë shlyer detyrimet tatimore mbi të ardhurat nga interesat, meqenëse shumat janë dhënë kundrejt një interesi të caktuar. Duke qenë se sipas

Aneksit të Kushtetutës, neni D, pasuri të ligjshme për qëllimet e ligjit të rivlerësimit konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, të ardhurat nga huadhëniet e parave me interes, për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, konsiderohen të paligjshme.

77.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur në vazhdimësi në deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI ka deklaruar kontara huaje dhe të ardhura të përfituara në formë interesash prej tyre. Por, sikurse është konstatuar edhe nga ILDKPKI-ja, dy prej këtyre kontratave nuk rezultojnë të deklarura në DPV-të vjetore.

Analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këto hua/vlerësimi i provave

78. Nga analiza e kryer më sipër, Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi prapësimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arriti në konkluzionin se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës prej 80,000 euro (70,000 euro nga të ardhurat dhe 10,000 euro dhurime) të deklaruar si pasuri në formë gjendje likuiditetesh *cash*, shumë e cila është referuar si e përdorur për dhënien e këtyre huave.

78.1. Në përputhje me bindjen e krijuar për pamundësinë financiare të krijimit të shumave të deklaruar në deklarimin fillestar të pasurisë (deklarimi i bërë veçmas) nga personi i lidhur si pasuri në formën e likuiditeteve *cash*, por nisur edhe nga fakti se huat e evidentuara si më sipër paraqiten me interesa të larta dhe duket se nuk kanë logjikë ekonomike, trupi gjykues ngre dyshime të arsyshme se kemi të bëjmë me kontrata fiktive huaje, të cilat nuk kanë sjellë si pasojë asnjë efekt financiar konkret për subjektin e rivlerësimit/personin e lidhur. Në këtë kuptim, në analizën financiare nuk janë përfshinë të ardhurat e deklaruar si të përfituara nga interesat e këtyre huave për sa kohë burimi i shumave të pretenduara si të dhëna hua, në çdo rast, nuk ka rezultuar i ligjshëm, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

78.2. Gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2020; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2020, të DRT-së Tiranë; dhe (iii) shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2020, të DRT-së Tiranë.

78.3. Nga verifikimi i këtyre shkresave, të cilat referojnë informacion mbi pagesat e tatimit mbi të ardhurat e pretenduara si të përfituara ndër vite prej personit të lidhur nga interesat e huave – Komisioni konstaton se detyrimi tatimor nuk është deklaruar dhe paguar në kohën e krijimit të të ardhurave, por se deklarimi dhe pagesat janë kryer gjatë vitit 2018 (referuar deklaratave DIVA në datë 27.12.2018).

78.4. Për më tepër, referuar dokumentacionit të sipërcituar (bashkëlidhur të cilit gjenden deklaratat DIVA) konstatohet se për të ardhurat e përfituara nga interesat e huave, me huamarrës z. S.V., tatimi është paguar nga ky i fundit, çka duket alogjike – për sa kohë të ardhurat janë pretenduar si të përfituara nga personi i lidhur, i cili bazuar në legjislacionin tatimor ka pasur detyrimin e deklarimit të këtyre të ardhurave dhe pagesës së tatimit përkatës.

79. Analiza financiare/ligjore e të ardhurave/pasurive në formë likuiditësh *cash* të deklaruar ndër vite, me burim krijimi dhurimet nga familjarët e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij

79.1. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore (DPV) të depozituara në ILDKPKI për vitet 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2014 dhe 2015 konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar dhurime nga familjarët e tyre në vlera monetare të konsiderueshme (në valutë), shumat si vijon:

- a. Në DPV-në e vitit 2005: (i) shumën prej 2,000 euro dhuratë nga vëllai subjektit, z. D. Q., veprim i kryer në datën 25.8.2005; dhe (ii) shumën prej 1,500 euro dhuratë nga motra e subjektit, znj. V. K., veprim i kryer në datën 5.9.2005;

- b. në DPV-në e vitit 2006: (i) shumën prej 1,000 euro dhuratë nga motra e subjektit, znj. V. K., (Q.), veprim i kryer në datën 30.8.2006;
- c. në DPV-në e vitit 2007: (i) shumën prej 3,000 euro dhuratë nga vëllai subjektit, z. K.Q.; (ii) shumën prej 2,500 euro dhuratë nga motra e subjektit, znj. A.P.; dhe (iii) shumën prej 2,500 euro dhuratë nga motra e subjektit, znj. M.Q.;
- d. në DPV-në e vitit 2008: (i) shumën prej 5,000 euro dhuratë nga vëllai i subjektit, z. D. Q.; (ii) shumën prej 4,000 euro dhuratë nga motra e subjektit, znj. A.P., (Q.); (iii) shumën prej 4,000 euro dhuratë nga motra e subjektit, znj. V.K., (Q.); dhe (iv) shumën prej 3,000 euro dhuratë nga vëllai i subjektit, z. K.Q., dhurime të bëra sipas vetëdeklarimit me rastin e martesës. Ndërsa bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si pasuri shumën prej 10,000 euro dhuratë nga familjarët, pasqyruar edhe më sipër;
- e. në DPV-në e vitit 2009: (i) shumën prej 2,500 euro të dhuruara nga motrat e subjektit; dhe (ii) shumën prej 1,500 euro dhuratë nga familjarët e bashkëshortes (me rastin e lindjes së vajzës);
- f. në DPV-në e vitit 2010: (i) shumën prej 2,000 euro dhuratë nga vëllezërit dhe motrat e subjektit; dhe (ii) shumën prej 1,000 euro dhuratë nga vëllai dhe motra e bashkëshortes (me rastin e lindjes së vajzës);
- g. në DPV-në e vitit 2011: (i) shumën prej 1,500 euro dhuratë nga familjarët e subjektit dhe bashkëshortes së tij, përkatësisht 1,000 euro nga vëllai dhe motrat e subjektit (P.Q., A.P., dhe V.K.) dhe 500 euro nga vëllai dhe motra e bashkëshortes (E.P., dhe D.L.);
- h. në DPV-në e vitit 2014: (i) shumën 100 euro dhuratë nga vëllai i bashkëshortes E., ose (A.) P.;
- i. në DPV-në e vitit 2015: (i) shumën prej 300 euro dhuratë nga vëllai i bashkëshortes E., ose (A.) P.; dhe (ii) shumën prej 400 USD dhuratë nga vëllai i subjektit, z. P.Q., (me rastin e lindjes së djalit).

79.2. Për sa më sipër rezulton se për vitet 2005 – 2015 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar në total shuma të dhuruara nga familjarët e tyre, në total 47,400 euro (përfshirë shumën prej 10,000 euro të deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën fillestare) dhe 400 USD.

79.3. Konstatohet se këto vlera monetare të pretenduara si të dhuruara nga familjarët në vazhdimësi janë deklaruar si pasuri në formë likuiditetesh *cash* të krijuara dhe të kursyera në vitet përkatëse të deklarimit dhe, në vijim, kanë shërbyer si burim për krijim pasurish të tjera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

79.4. Referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe të pikës 4 të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 familjarët e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

79.5. Komisioni i kërkoi subjektit të deklaronte burimin e të ardhurave të familjarëve të tij dhe të bashkëshortes, të cilët kanë shërbyer si burim krijimi për dhurimet e deklaruara, ndër vite, si edhe të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të provuar deklarinimet e tij⁴⁷.

79.6. Nga analizimi i deklarinimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti, duket se pretendimet e tij për të ardhurat e realizuara nga familjarët dhe bashkëshortja dhe burimi i krijimit të tyre janë kryesisht të karakterit deklarativ.

79.7. Në analizën e kryer për burimin e të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes së subjektit për dhurimin e shumës prej 10,000 euro, rezultoi se ata nuk justifikonin me burime financiare të ligjshme dhurimin e kësaj shume. Subjekti ka paraqitur të njëjtat shpjegime dhe prova për burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për dhurimet e kryera nga familjarët e bashkëshortes të deklaruara pas DPV-së së vitit 2008. Si rrjedhim, duket se subjekti nuk ka

⁴⁷ Pyetja nr. 2/ Pyetësori nr. 2.

provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të familjarëve të bashkëshortes për dhurimet e pretenduara dhe të deklaruara ndër vite.

79.8. Ndërsa për të ardhurat e familjarëve të tij (motrave dhe vëllezërve) subjekti i rivlerësimit ka depozituar ekstraktin e sigurimeve shoqërore të bashkëshortit të motrës së tij (A.P.) për të dhëna të punësimit në shtetin italian për periudhën 1.12.1995 – 31.12.2008, si dhe pasqyra financiare të motrës V.K., dhe bashkëshortit të saj për të ardhura të realizuara në shtetin grek.

79.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar konstatohet se nuk është në formën e kërkuar nga ligji (i përkthyer dhe i legalizuar – me vulë apostile).

80. Ndërsa, për familjarët e tjerë subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar deklarata noteriale me qëllim për të justifikuar burimin e krijimit të të ardhurave të tyre, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të dhuruara në favorin e tij. Pra, subjekti ka dhënë vetëm shpjegime të karakterit deklarativ për të ardhurat e tyre dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor.

80.1. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këto hua/vlerësimi i provave

81. Pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vëren se subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor (të legalizuar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe) për të ardhurat e realizuara në shtetin italian nga z. A.P.,⁴⁸ – bashkëshorti i znj. A.P., (motrës së subjektit) dhe për të ardhurat e realizuara në shtetin grek nga znj. V.K.,⁴⁹ (motra e subjektit) dhe z. A.K., (bashkëshorti i motrës së subjektit).

81.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar dhe nga analiza e të ardhurave të evidentuara si të realizuara ndër vite nga shtetasit e sipërcituar, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimet e kryera – të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, të referuara si më sipër.

81.2. Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të familjarëve të tjerë (familjarët e tij dhe bashkëshortes së tij) subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor për të provuar mundësinë e krijimit të të ardhurave të tyre – të pretenduara si burim për shumat e dhuruara në favor të tij dhe personit të lidhur. Komisioni vëren se prapësimet e subjektit janë kryesisht të karakterit deklarativ dhe nuk mbështeten në dokumentacionin ligjor provues.

81.3. Komisioni vëren se në deklarimin e disa dhurimeve në vite, subjekti ka deklaruar shumën e dhuruar në total – nga disa familjarë, pa bërë evidentimin të pjesës përkatëse të dhuruar nga secili familjar më vete.

81.4. Sa më sipër, në analizën përfundimtare financiare do të reflektohen si të ardhura vetëm dhurimet e deklaruara nga motrat e subjektit, A.P., dhe V.K., për vitet ku janë përcaktuar qartë këta persona të tjerë të lidhur si dhurues dhe shuma përkatëse e deklaruar si e dhuruar.

82. Pasuria e llojit “apartament banimi”⁵⁰ me sipërfaqe 107.16 m², porositur me kontratën e sipërmarrjes së datës 11.3.2010, me vlerë 40,000 euro – me burim krijimi kursimet e krijuara

⁴⁸ Dokumenti ekstrakt llogarie sigurimesh shoqërore lëshuar nga INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore – Itali) që referon të ardhura për vitet 1995 – 2020.

⁴⁹ Dokumenti, njoftim i vlerësimit të tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Greqi, që referon të ardhura për vitet 2001 -2019.

⁵⁰ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (i) kontratë sipërmarrjeje datë 11.3.2000; (ii) aneks kontratë sipërmarrjeje datë 6.1.2015; (iii) mandatarëkëtimi në “Intesa Sanpaolo Bank” datë 11.3.2010; dhe (iv) deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.5.2014, ku në cilësinë e deklaruësit shfaqet shoqëria “***” sh.p.k.

nga të ardhurat e deklaruara ndër vite. Subjekti ka deklaruar se në datën 6.1.2015 ka hequr dorë nga blerja e vendparkimit, reflektuar me dokumentin aneks kontrate datë 6.1.2015 që shoqëron kontratën e sipërmarrjes datë 11.3.2010.

82.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV-së së vitit 2010 në rubrikën “Pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme (shtesa/pakësime)” ka deklaruar se shuma prej 40,000 euro është shpenzuar si pagesë për prenotim shtëpie, me burim krijimi paratë e kursyera gjatë viteve të punës.

82.3. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: (i) fshehje nga subjekti i vendparkimit në pallatin në rr. “****” Tiranë, në deklaratat e interesave private në ILDKPKI, në vitet 2010 – 2015; dhe (ii) deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit në Rr. “****” Tiranë, në vitin 2010, me të ardhura nga dhuratat e të afërmeve për justifikimin e të cilave ka mungesë dokumentacioni ligjor. Gjithashtu, referuar deklarimeve ndër vite, vetëm një pjesë e tyre rezultoi e deklaruar si kursime.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

83. ZVRPP-ja Tiranë⁵¹ konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit është e regjistruar pasuria me nr. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “apartament” me sipërfaqe 95.3 m².

83.1. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në datën 11.3.2010 subjekti i rivlerësimit ka porositur të shoqëria “****”: (i) ambientin me sip. 107.16 m², ku përfshihen dhe sipërfaqet e përbashkëta; si dhe (ii) një vendparkim të vijëzuar në objektin e ndërtuar në rr. “****” Tiranë.

83.2. Në nenin 3 të kontratës së porosisë me titull “çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës” përcaktohet se çmimi objekt kontrate të jetë 40,000 euro, i cili do të likuidohet totalisht brenda vitit 2010, ndërsa vlera e vendparkimit do të përcaktohet dhe do të likuidohet gjatë vitit 2012.

83.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti duket se pagesa prej 40,000 euro në datën 11.3.2010 është depozituar *cash* në bankë nga subjekti i rivlerësimit dhe nëpërmjet mandatit bankar të “Intesa Sanpaolo Bank” konfirmohet se ka kaluar në emër të përfaqësuesve të shoqërisë “****” sh.p.k.

83.4. Konstatohet se në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar shumën prej 40,000 euro si pagesë për prenotim shtëpie, por nuk ka referuar të dhëna të tjera identifikuese për vendndodhjen e saj, shoqërinë në të cilën e ka prenotuar, etj., si dhe nuk ka deklaruar prenotimin e pasurisë së llojit “vendparkimi”.

83.5. Nëpërmjet deklaratës noteriale⁵² të datës 23.5.2014, shoqëria “****” sh.p.k., ndër të tjera, deklaroi se nuk është zgjidhur problemi i parkimit me subjektin e rivlerësimit dhe nuk është likuiduar çmimi për këtë pasuri.

83.6. Ndërsa me dokumentin “Aneks kontrate të sipërmarrjes së datës 11.3.2010”, në datën 6.1.2015 pala porositëse heq dorë nga blerja e vendparkimit dhe pala sipërmarrëse është dakord me heqjen dorë nga porositësi.

83.7. Rezulton se në datën 17.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes me shoqërinë “****” sh.p.k. për apartamentin e porositur me kontratën e datës 11.3.2010.

83.8. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e çmimit për blerjen e kësaj pasurie.

⁵¹ Shkresa nr. *** prot., datë 20.2.2019.

⁵² Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.5.2014.

83.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit

84. Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka pasur kursime ndër vite, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e shumës për kryerjen e pagesës prej 40,000 euro në favor të shoqërisë ndërtuese për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

84.1. Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi shpjegimet dhe provat e depozitura nga subjekti i rivlerësimit, vëren se krahas kursimeve të tij nga paga, subjekti pretendon se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat e kursyera nga dhurimet e familjarëve të tij ndër vite, për të cilat u arrit në përfundimin se pjesa që përfaqëson vlerën më të madhe të tyre nuk justifikohen me burime financiare të ligjshme. Për më tepër, vërehet se subjekti vetëm një pjesë të këtyre dhurimeve i ka deklaruar si kursime.

84.2. Gjithashtu, në prapësimet e dërguara, subjekti ka pretenduar se në vitin 2009 ka pasur të depozituar shumën prej 1,050,000 lekësh në “Raiffeisen Bank” – pa deklaruar burimin, për të cilën deklaroi se e ka tërhequr gjatë vitit 2010, duke pretenduar se kjo vlerë ka shërbyer si burim për kryerjen e pagesës për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

84.3. Nga verifikimi i llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”⁵³ (llogaria në lekë me nr. ***) konstatohet se në vitin 2009 janë krijuar 3 depozita, në datat dhe vlerat si vijon: (i) në datën 4.6.2009 në vlerën prej 500,000 lekësh; (ii) në datën 4.11.2009 në vlerën prej 400,000 lekësh; dhe (iii) në datën 11.11.2009 në vlerën prej 158,000 lekësh. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, konstatohet se deri në datën 11.3.2010 – evidentuar si datë e kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit për pasurinë objekt vlerësimi nuk janë kryer tërheqje nga këto shuma të investuara në depozita. Për rrjedhojë, Komisioni arrin në përfundimin se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit se shumatat e investuara në llogari depozitë gjatë vitit 2009 të kenë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit në Tiranë.

84.4. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës prej 40,000 euro, në datën 11.3.2020 – paguar si çmim për blerjen e apartamentit në pronësi të subjektit, të pasqyruar në tabelën, si vijon:

Tabela nr. 3

Përshkrimi	Deri më 11.3.2010 (vlerat/lekë)
Pasuri	3,939,843
Apartament me sip. 107.16 m ² në Tiranë, 40.000 euro ⁵⁴	5,552,400
Shtesa /pakësime në likuiditete	- 1,612,557
Të ardhurat	255,022
Të ardhura nga paga subjekti	176,077
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit	78,945
Shpenzime	79,695
Shpenzime jetese ⁵⁵	79,695
Të ardhura - pasuri - shpenzime	-3,764,516

84.5. Për sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë së llojit “apartament”, prenotuar dhe paguar në vitin 2010.

85. Pasuria e llojit “automjet”⁵⁶, blerë në datën 15.1.2013, në vlerën 3,000 euro. Burim krijimi: të ardhurat nga paga.

85.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV-së së vitit 2013 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë pasurie automjetin e blerë në datën 15.1.2013, me vlerë 3,000 euro. Burim krijimi: të ardhurat nga kursimet.

⁵³ Informacion i ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2019, të “Raiffeisen Bank”

⁵⁴ Konvertuar në lekë referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010.

⁵⁵ Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së.

⁵⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): kontaktë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.1.2013.

85.2. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRr-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

86. DPSHTRr-ja⁵⁷ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi automjetin me targa AA *** dhe nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti konstatohet se në datën 15.1.2013 ka blerë pasurinë e llojit automjet tip “Daimlerchrysler C 220 CDI” për shumën 3,000 euro.

86.1. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

87. Gjendje likuiditetesh në formë kursimesh *cash*, datë 29.1.2017, në vlerën prej 1,400,000 lekësh.

87.1. Konstatimi i ILDKPKI-së: nuk ka qenë e qartë gjendja *cash* në fund të viteve deklaruese në ILDKPKI, pasi subjekti ka deklaruar kursimet, por pakësimet nuk i ka të specifikuar, duke qenë se i ka në lekë dhe valutë dhe të ndara me bashkëshorten.

87.2. Referuarvetëdeklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, duket se ecuria e krijimit të gjendjeve të likuiditeteve *cash* vit pas viti paraqitet në tabelën, si vijon⁵⁸:

Viti	Shtesat në kursimet <i>cash</i>	Gjendja në fund të vitit
2007	700,000	700,000
2008	1,271,916	1,971,916 ⁵⁹
2009	-	1,971,916 ⁶⁰
2010	1,089,686	_61
2011	800,000	800,000
2012	650,000	1,450,000
2013	300,000	1,750,000
2014	500,000	2,250,000
2015	500,000	2,750,000
2016	600,000	950,000 ⁶²

⁵⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 5.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 7.2.2019.

⁵⁸ Referuar deklarimeve të subjektit dhe personit të lidhur të bëra në deklaratat periodike vjetore si dhe referuar deklarimeve të subjektit në ILDKPKI – nëpërmjet pyetësorëve.

⁵⁹ Në kursimet *cash* në fund të vitit 2008 janë përfshirë kursimet e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në shumën 794,664 lekë, si dhe shuma prej 477,252 lekësh që përfaqëson shumën që ka pasur mundësi të kursejë bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

⁶⁰ Në DPV-në e vitit 2009, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: “Paga e marrë gjatë vitit 2009 kursyer në shumën 800,000 lekë...depozituar në bankë disa para nga të ardhurat e rrogës sipas numrit të llogarisë... këto të kursyera nga viti 2008-2009 në shumën 1.050.000 lekë.” Por, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit nga bankat e nivelit të dytë rezulton se në vitin 2009 subjekti i rivlerësimit ka çelur 3 depozita: (i) në qershor të vitit 2009 ka çelur depozitën prej 500,000 lekësh; dhe (ii) në nëntor të vitit 2009 ka çelur 2 depozita në shumën 558,000 lekë. Referuar transaksioneve bankare rezulton se subjekti nuk i ka krijuar këto depozita nga derdhje *cash*, por ato janë krijuar nga akumulimi në llogarinë rrjedhëse të pagave të subjektit, të cilat rezultojnë se nuk janë tërhequr dhe janë përdorur si burim për krijimin e depozitave, pra, ato nuk rezultojnë si kursime në gjendje *cash* në fund të vitit.

⁶¹ Në deklarinimin e bërë në ILDKPKI më 25.11.2011, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “Pavarësisht shumave të deklaruara, të kursyera, në *cash* në lekë, pas prenotimit të apartamentit dhe rregullimeve të tjera të kryera në të gjatë ndërtimit, deklarom me përgjegjësi se edhe gjendja *cash* në lekë më 31.12.2010 është 0 lekë”.

⁶² Gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2016 sipas deklarimeve të subjektit rezulton të ketë qenë në shumën 3,350,000 lekë, shumë së cilës i është zbritur shuma prej 700,000 lekësh e përdorur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për prenotimin e apartamentit dhe shuma prej 1,700,000 lekësh e dhënë hua nga subjekti vëllait të tij në vitin 2016.

87.3. Nisur nga analiza e kryer sa më sipër, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit nuk ka dokumentuar me burime financiare të ligjshme pasuritë e deklaruara nga bashkëshortja në deklaratën fillestare të pasurisë, pjesën më të madhe në vlerë të dhurimeve të deklaruara ndër vite, të ardhurat e pretenduara nga interesat e huave, si edhe në konsideratë të analizës financiare sipas së cilës disa vite rezultojnë me balancë negative të fondeve⁶³ (përfshirë këtu edhe vitin 2016).

87.4. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar disponimin e gjendjes *cash* në shumën prej 1,400,000 lekësh në datën 29.1.2017.

Deklarimi i pasurive veçmas nga personi i lidhur, znj. K. Q.,

88. Pasuria e llojit “tokë bujqësore”⁶⁴ me sip. 3.843,5 m², e ndodhur në fshatin *, blerë në datën 12.3.2015, në shumën 10,000 USD. Burim krijimi: të ardhurat ndër vite.**

88.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV-së së vitit 2015 konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e paluajtshme, tokë me sip. 3.843,5 m², me çmim 10,000 USD, si pasuri personale të bashkëshortes, blerë me kursimet e saj ndër vite.

88.2. Konstatimi i ILDKPKI-së: dyshime lidhur me çmimin e blerjes së tokës arë me sip. 3.843,5 m² me vlerë 10,000 USD në ***, Durrës, pasi blerja në vitin 2015 rezulton me vlerën 2,6 USD/m² apo rreth 320 lekë/m².

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

89. ZVRPP-ja Durrës⁶⁵ konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes është regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “tokë arë” me sip. 3.845,5 m² dhe se kjo pasuri është fituar me kontratën e shitblerjes⁶⁶ së datës 12.3.2015, lidhur mes shtetas K.Q., në cilësinë e blerësit dhe shtetasit B. Gj., në cilësinë e shitësit. Referuar kësaj kontrate, bashkëshortja e subjektit ka blerë këtë pasuri për vlerën 10,000 USD.

89.1. Nisur nga analiza e kryer sa më sipër, sipas së cilës personi i lidhur nuk zotëron dokumentacion justifikues ligjor për: (i) pasuritë e deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë (likuidete *cash*); dhe (ii) dhurimet e deklaruara ndër vite – që ka sjellë si pasojë mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të pretenduara nga interesat e huave, si edhe në konsideratë të analizës financiare sipas së cilës disa vite rezultojnë me balancë negative të fondeve⁶⁷ (përfshirë këtu dhe vitin 2015) duket se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

89.2. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit

90. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit i qëndron pretendimeve të deklaruara edhe më parë se të gjitha të pasuritë në formë likuiditetesh *cash* të deklaruara nga bashkëshortja e tij në deklaratën periodike të vitit 2008 si person i lidhur, janë të krijuara me burime financiare

⁶³ Tabela e analizës së plotë financiare, bashkëlidhet si Aneks ***, i këtij vendimi.

⁶⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks ***në dosjen e ILDKPKI-së): (i) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2015 dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj; (ii) mandatarkëtimi në BKT, datë 12.3.2015; dhe (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 20.3.2015 + harta treguese + kartelë pasurie.

⁶⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 22.2.2019.

⁶⁶ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2015.

⁶⁷ Tabela e analizës së plotë financiare, bashkëlidhet si Aneks ***, i këtij vendimi.

të ligjshme dhe, si rrjedhojë, ka pasur burime financiare për dhënien e huave (të pretenduara si të dhëna nga personi i lidhur ndër vite), duke përfiturar të ardhurat të ligjshme nga interesat.

90.1. Komisioni, më sipër ka kryer analizë të detajuar për ligjshmërinë e të ardhurave që pretendohet se kanë mundësuar krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh cash të deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën periodike të vitit 2008 (deklarimi për herë të parë i personit të lidhur për shkak të lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit). Nga analiza e kryer, Komisioni arriti në përfundimin se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh cash – deklaruar në vitin 2008 në vlerën prej 80,000 euro.

90.2. Si rrjedhim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi nuk provon ligjshmërinë e burimeve financiare për blerjen e kësaj pasurie (pasuri kjo e regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij), deklaruar me burime nga të ardhurat dhe kursimet e personit tjetër të lidhur.

91. Pasuria e llojit “apartament banimi”⁶⁸, me sip. 159.36 m², prenotuar/porositur në datën 5.1.2016, me vlerë 82,862 euro. Personi i lidhur ka deklaruar se ka likuiduar vlerën prej 81,941 euro dhe se detyrimi i mbetur pa paguar është në vlerën 921 euro. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar se për plotësimin e kësaj vlere të paguar është përdorur shuma prej 700,000 lekësh nga të ardhurat familjare të kursyera pas vitit 2011, të cilat pakësohen.

91.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV-së së vitit 2016 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar prenotimin nga bashkëshortja të pasurisë së llojit “apartament banimi” me sip. 159.35 m², ndodhur në ***, Kashar, Tiranë, me vlerë 82,862 euro. Subjekti ka deklaruar se përgjatë vitit 2016 është shlyer shuma prej 68,441 euro. I njëjti deklarim është bërë edhe nga personi i lidhur për këtë pasuri.

91.2. Gjithashtu, në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka pakësuar shumën prej 700,000 lekësh nga të ardhurat familjare të kursyera pas vitit 2011, të cilat i janë dhënë bashkëshortes për prenotim apartamenti personal.

91.3. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: mungesë burimi të ligjshëm financiar për shumën e përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 159.36 m², në Kashar, Tiranë dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e deklaruar në deklaratën e vitit 2016. Në deklaratën e rivlerësimit nuk është përcaktuar burimi financiar.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

92. Konstatohet se nëpërmjet kontratës së porosisë së datës 5.1.2016 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. K.Q., ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe totale 159.35 m², të ndodhur në objektin në ndërtim/ndërtuar nga shoqëria e sipërcituar, në Kashar, Tiranë, për vlerën totale prej 82,862 euro.

92.1. Referuar kësaj kontrate, plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) kësti parë në shumën prej 7,353 euro do të paguhet në datën 5.1.2016 me lidhjen e kontratës; (ii) kësti i dytë në shumën prej 8,088 euro në datën 3.2.2016; (iii) kësti i tretë në shumën 20,000 euro në datën 15.6.2016; (iv) kësti i katërt në shumën 10,000 euro në datën 8.8.2016; (v) kësti i pestë në shumën 12,000 euro në datën 29.9.2016; (vi) kësti i gjashtë në shumën 11,000 euro në datën 24.10.2016; (vii) kësti i shtatë në shumën 13,500 euro në datën 13.1.2017; dhe (viii) kësti i fundit në shumën 921 euro do të paguhet me lidhjen e kontratës së shitblerjes.

92.2. Pra, referuar kontratës së porosisë dhe deklarimeve të bëra nga subjekti/personi i lidhur konstatohet se deri në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” është paguar në total

⁶⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (i) kontratë porosie datë 5.1.2016 lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.; dhe (ii) mandatarkëtime për pagesat e kryera në vitet 2016 dhe 2017, copë 6 (gjashtë).

shuma prej 81,941 euro. Por, rezulton se subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar plotësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie.

92.3. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e çmimit për blerjen e kësaj pasurie.

92.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit

93. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit i qëndron pretendimeve të deklaruara edhe më parë se të gjitha të pasuritë në formë likuiditetesh *cash* të deklaruara nga bashkëshortja e tij në deklaratën periodike të vitit 2008 si person i lidhur, janë të krijuara me burime financiare të ligjshme dhe, si rrjedhojë, ka pasur burime financiare për dhënien e huave (të pretenduara si të dhëna nga personi i lidhur ndër vite) duke përfituar të ardhura të ligjshme nga interesat.

93.1. Komisioni kreu analizë të detajuar për ligjshmërinë e të ardhurave që pretendohet se kanë mundësuar krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh *cash* të deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën periodike të vitit 2008 (deklarimi për herë të parë i personit të lidhur për shkak të lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit). Nga analiza e kryer, Komisioni arriti në përfundimin se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh *cash* – deklaruar në vitin 2008 në vlerën prej 80,000 euro.

93.2. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës prej 81,941 euro deri më 13.1.2017 – paguar si çmim për blerjen e apartamentit në ***, Kashar, pasqyruar në tabelën, si vijon:

Analiza financiare për periudhën 1.1.2016 – 13.1.2017	Vlerat në lekë
Pasuri	7,803,562
Apartament banimi në *** me sip.159.35 m ² 81,941 euro ⁶⁹	11,052,839
Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë	-3,249,277
Detyrime	-1,700,000
Hua dhënë vëllait në shumën 1,700,000 lekë	-1,700,000
Të ardhurat	2,265,476
Të ardhura nga punësimi subjekti	1,551,034
Të ardhura nga punësimi bashkëshortja	251,013
Të ardhura të përfituara nga leja e lindjes bashkëshortja e subjektit	103,629
Të ardhura të përfituara nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit për vitin 2016	359,800
Shpenzime	1,217,907
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	1,217,907
Të ardhura - Pasuri – Shpenzime	- 8,455,993

93.3. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratën “Vetting” kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, pasi nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të saj. Gjithashtu rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe

⁶⁹ Konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e pagesës prej 81,941 euro deri më 13.1.2017 – për blerjen e pasurisë së llojit “apartament” të ndodhur në ***, Kashar.

Analiza financiare për vitet 2003 – 2016

94. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ si shpjegimet dhe provat e depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për çdo vit, për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultojnë edhe vitet 2010, 2014, 2015 dhe 2016 paraqiten me balancë negative të fondeve (ku përfshihet edhe analiza e kryer për vitet në të cilat është analizuar më vete krijimi i aseteve në momentin e kryerjes së pagesave, paraqitur veçmas si më sipër) dhe konkretisht: (i) për vitin 2010 balanca negative e fondeve (- 3,149,461 lekë) ; (ii) për vitin 2014 balanca negative e fondeve (- 316,940 lekë) ; (iii) për vitin 2015 balanca negative e fondeve (-1,217,383 lekë); dhe (iv) për vitin 2016 balanca negative e fondeve (- 8,093,418 lekë).

94.1. Për sa më sipër, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive, investimet e realizuara, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet e pasqyruara si më sipër⁷⁰.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

95. Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e të gjitha pasurive dhe njëkohësisht kryerjen e shpenzimeve ndër vite.

95.1. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, si dhe duke konsideruar edhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, **trupit gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë, të rremë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, parashikuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.**

B. KONTROLI I FIGURËS

96. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka dërguar në datën 2.11.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për këtë subjekt rivlerësimi.

96.1. Në vijim, Komisioni ka kërkuar informacion të përditësuar nga organet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore në kreun V të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, në vijim të hetimit Komisioni i ka kërkuar DSIK-së në datën 22.10.2019, përditësimin e informacionit të dërguar me raportin e datës 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit dhe deklasifikimin e tij.

96.2. DSIK-ja⁷¹ dërgoi në Komision në datën 9.3.2020 raportin e përditësuar⁷² për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa. Në këtë raport, grupi i punës konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa.

⁷⁰ Tabela përmbledhëse e analizës financiare, bashkëlidhet si Aneks 1, i këtij vendimi.

⁷¹ Shkresa nr. *** prot., datë 17.4.2020.

⁷² Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 14.4.2020, të KDZh-së.

96.3. Në raport argumentohet se mbështetur në të dhënat që disponohen për implikimin në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, si dhe kohëzgjatjen më shumë se një herë e të shtrirë vazhdimisht në kohë të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme, e gjen subjektin e rivlerësimit në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale dhe e bën një individ që të mund të vihet lehtësisht nën presion nga struktura kriminale.

96.4. Si rrjedhojë, mbi bazën e të dhënave që grupi i punës së DSIK-së disponon për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa, në cilësinë e gjyqtarit, gjatë fazës së gjykimit të një çështjeje penale, marrëdhënia korruptive e vendosur mes tij dhe palës tjetër, që mund të jetë personi nën hetim apo gjykim, është marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm, në papajtueshmëri të plotë me detyrën e tij funksionale.

96.5. Komisioni, nisur nga informacioni i ardhur, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, kreu një hetim duke kërkuar materialet e referuara, analizoi dhe vlerësoi në tërësi provat e administruara dhe në përfundim të këtyre hetimeve, duket se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese – të mbajtur parasysht në hartimin e raportit nga autoriteti verifikues i figurës (grupi i punës pranë DSIK-së).

96.6. Në përfundim të verifikimeve lidhur me vlerësimin e figurës, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimeve të pasqyruara në raportin e DSIK-së, në raport me vlerësimin e bërë nga Komisioni për disa çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, të pasqyruara në materialin “Rezultatet e hetimit administrativ” – dërguar subjektit.

96.7. Në shpjegimet për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka mohuar të ketë dijeni për rastet e cituara në raportin e DSIK-së dhe se nuk kupton se për cilat raste bëhet fjalë. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: *“DSIK-ja në raportin e datës 2.11.2017 ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, duke iu përmbajtur objektit të kontrollit të figurës, përcaktuar në nenin 34 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: ‘Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Neni Dh i Aneksit të Kushtetutës parashikon se: ‘1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja. 2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1.1.2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit...’. Në kuptim të përmbajtjes së dispozitave të sipërcituara, DSIK-ja do të duhej që edhe raportin e detyrës, me të cilin rezultati përmbysëj, ta kishte përpiluar duke u bazuar në objektin dhe kufijtë ligjorë të verifikimit të figurës”.*

96.8. Parashtruar në mënyrë të përmbledhur, subjekti pretendon se DSIK-ja nuk ka bërë me dije burimin e informacioneve (mbi bazën e të cilave është ndryshuar raporti) apo të dhëna konkrete për veprimet korruptive. Gjithashtu, subjekti pretendon se për periudhën 1.1.2012 deri në datën e dorëzimit të deklaratës “Vetting” të figurës (periudha e rivlerësimit) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Pra, vetëm në rast identifikimi të kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar përgjatë periudhës së përcaktuar me ligj, do të justifikoheshin ndryshimet e raportit të kontrollit të figurës nga ana e DSIK-së.

96.9. Lidhur me pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit se në raportin e DSIK-së referohen të dhëna jashtë peridhës së rivlerësimit të figurës, Komisioni, bazuar në situatën faktike si më sipër dhe në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, arsyeton se ligji nr. 84/2016, në nenin 34 të tij parashikon se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Pika 2, e nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës përcakton se subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1.1.2012 deri në ditën e deklarimit. Deklarata e figurës, shtojca nr. 3 e ligjit nr. 84/2016 në pjesën 2 “Të dhëna për vendin e banimit”, në pjesën 4 “Të dhëna për punësimin”, si dhe në pjesën 5 “Të dhëna për sigurinë”, në gërmat “a”-“f” dhe “h”, kërkon që subjekti i rivlerësimit të japë të dhëna duke filluar nga data 1.1.2012. Ndërsa në gërmën “g”⁷³ të pjesës 5 kërkohen të dhëna për 10 vitet e fundit, në ndryshim nga afati i përcaktuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Ligji nr. 84/2016, i cili detajon procedurën e kontrollit të figurës, të kryer nga grupi i punës i DSIK-së dhe Komisioni, në asnjë rast nuk e kufizon kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit vetëm “për periudhën nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklarimit” (janar 2017). Bazuar në pikat 4 dhe 6, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy elemente që plotësojnë njëri-tjetrin: konstatimin e ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, çka përbën elementin përmbajtësor të këtij kontrolli dhe konstatimin e plotësisë dhe besueshmërisë së deklarimit, çka përbën elementin formal të këtij kontrolli. Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklarimit kontrollohen për periudhën e deklaruar në Aneksin e Kushtetutës, ndërsa për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1.1.2012 dhe pas dorëzimit të deklaratës/formularit.

97. Trupi gjyqësor i Komisionit vlerëson se fillimi i procedurës për kontrollin e figurës, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016, referon fillimisht mbi verifikimin e afatit të dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës nr. 3 të këtij ligji dhe, më tej, mbi verifikimin e saktësisë së saj në përputhje me standardet e plotësimit, sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 38 të këtij ligji.

97.1. Sipas pikës 2 të nenit 39, raporti i DSIK-së duhet të përcaktojë nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë, që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës.

97.2. Trupi gjyqësor i Komisionit vlerëson se rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, përcaktohen në pikën 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe janë kur: “a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.”

97.3. Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni nuk rezultoi për subjektin e rivlerësimit ndonjë nga rrethanat e parashikuara të pikës 6 të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Në raportin e përditësuar të DSIK-së, me nr. {***} prot., datë 17.4.2020, citohet se nga të dhënat që disponohen për

⁷³ Të dhëna për refuzimin e hyrjes në ndonjë shtet të BE/NATO.

subjektin e rivlerësimit vlerësohen për aktualitetin dhe kohëzgjatjen, pra, më shumë se një herë të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës. Në përfundim, grupi i punës, bazuar në germa “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar duke e vlerësuar subjektin si individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, duke pasqyruar rrethana, të cilat lidhen drejtpërdrejt me veprimet dhe mosveprimet e dyshuara të subjektit të rivlerësimit.

97.4. Si përfundim, Komisioni vlerëson se referuar standardit të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit nuk i atribuohet asnjë kontakt i çfarëdolloji me subjekte që janë përfshirë apo dyshohen si pjesëtarë të strukturave të organizuara kriminale.

97.5. Gjithsesi, qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Ligji, duke urdhëruar verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, nuk mund të përjashtojë verifikimin e figurës së subjektit, nëse ka dyshime të bazuara se ai është përfshirë në krimin e organizuar, sipas pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht në korrupsion pasiv. Korrupsioni në sistemin e drejtësisë lidhet me ndikimet e padrejta që prekin pavarësinë e drejtësisë si sistem dhe/ose pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve si individë.

97.6. Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit është theksuar në një numër aktesh ndërkombëtare, si: “Parimet themelore të pavarësisë së sistemit të drejtësisë” i OKB-së, 1985; “Parimet e Bangalor-it për sjelljen në sistemin gjyqësor”, 2002; “Udhëzuesi evropian për etikën dhe sjelljen e prokurorëve” i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, 2005 etj.

97.7. Ndërsa pika 3 e nenit 15 të ligjit nr. 84/2016 parashikon që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar” duhet të jetë dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (në vijim, ligji nr. 10192/2009, i ndryshuar).

97.8. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësisë të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

97.9. Si konkluzion, trupi gjykues i Komisionit çmon se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikës 2 apo 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, porse konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, z. Arjan Qafa, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor⁷⁴

98. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar një raport për analizën e aftësive profesionale, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të cilat janë paraqitur prej tij; (ii) pesë dosjeve

⁷⁴ Raporti nr. *** prot., datë 19.4.2019.

të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

98.1. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Arjan Qafa janë paraqitur 4 ankesa (në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Tri ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, një ankesë me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe dy ankesa me arsyetimin se pretendimet janë jashtë kompetencave të KLD-së. Një ankesë verifikuar mbi bazën e informacionit të paraqitur nga kryetari, lidhur me përdorimin e sistemit *audio*, është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara. Ndërsa, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Arjan Qafa përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

98.2. Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 15.3.2016, ka ushtruar detyrën e inspektorit të KLD-së, në seksionin e inspektimit dhe të verifikimit të ankesave, sipas urdhrin nr. 8, datë 19.4.2013 “Për ndarjen e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksione”, si dhe bazuar në urdhrat e kryeinspektoreve ka kryer edhe vlerësimin etiko-profesional të gjyqtarëve dhe prej marsit të vitit 2016 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

98.3. Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, për periudhën që ka ushtruar detyrën e inspektorit, ka realizuar vlerësime etiko-profesionale të gjyqtarëve dhe inspektime e verifikim ankesash, duke qenë në standardin sasior.

98.4. Referuar raportit, në vlerësim të subjektit të rivlerësimit për funksionin e tij si inspektor i KLD-së, konstatohet se thelbi i detyrës kuptohet saktësisht prej tij dhe përmbushet në funksion të respektimit të kornizës ligjore e n/ligjore dhe afateve të vendosura. Veprimet procedurale dokumentohen rregullisht dhe qartë, si dhe nuk ka mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse. Ai identifikon saktë rrethanat e çështjes dhe ligjin e aplikueshëm në paraqitjen e plotë të detajeve të verifikuara, si dhe në krijimin e dosjes në mënyrë të plotë dhe profesionale.

98.5. Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, në ushtrimin e detyrës së inspektorit të KLD-së identifikon qartë problematikën e çështjes, duke i kushtuar rëndësi këtij hapi të parë në proces. Ai zotëron dhe shpreh një nivel të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën.

98.6. Në vlerësimin e tij si gjyqtar, subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, konstatohet se në përgjithësi identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe shfaq aftësi në arsyetimin ligjor.

98.7. Për gjyqtarin Arjan Qafa konstatohet se ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, si dhe bën përpjekje për përfundimin në kohë të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësinë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore tepër e lartë. Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjes.

98.8. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, dhe nga pesë dosjet/dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

99. Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr.

96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

99.1. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

99.2. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

99.3. Në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 33 denoncime të depozituara nga publiku në Komision.

99.4. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me gjetjet e konstatuara nga raporti i KLGJ-së dhe nga verifikimi i denoncimeve të depozituara në Komision. Subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi gjetjet në raportin e KLGJ-së, si edhe problematikat e ngritura në denoncimet e publikut, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të mjaftojnë për të mbërritur në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

100. Në një vlerësim të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në një mungesë të aftësive profesionale.

100.1. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

101. Nga vlerësimi në tërësi i rezultateve të hetimit, trupi gjykues i Komisionit çmon se qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar e që cenojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Ligji, duke urdhëruar verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, nuk mund të përjashtojë verifikimin e figurës së subjektit, nëse ka dyshime të bazuara se është përfshirë në korrupsion pasiv, ku, nëpërmjet ndikimeve të padrejta, preket pavarësia në sistemin e drejtësisë, si dhe/ose pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve si individë.

102. Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit duhet të qëndrojë në themel të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Arjan Qafa, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit të të ardhurave/pasurive dhe vlerësimit profesional, rëndojnë pozitën e tij si gjyqtar. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të

vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 17.9.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore

ANEKS 1 - ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

	Burimi	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuri		600 000	217 380	161 064	-206 141	-129 280	910 067	1 662 992	9 786	3 761 456	207 297	617 042	711 451	505 744	1 889 396	7 371 512
Tokë Bujqësore 6,000 m ²		600 000														
Tokë pylli me sipërfaqe 1.000 m ² blerë 18.02.2008								200 000								
Tokë Bujqësore me sip.1639 m ²	fituar me ligj															
Tokë Bujqësore 1/10 e sip.1955 m ²	fituar me ligj dhe nga trashëgimnia															
Apartament banimi me sip.107.16 m ²										5 552 400						
Makinë e blerë në vitin 2013													420 630			
Tokë me sip.3843.5 m ² , blerë nga bashkëshortja 10,000 \$															1 266 400	
Apartament banimi në Yzberisht me sip.159.35 m ²																9 258 014
Shtesa/pakësimi likuiditete CASH dhe bankë			217 380	161 064	-206 141	-129 280	910 067	1 462 992	9 786	-1 790 944	207 297	617 042	290 821	505 744	622 996	-1 886 503
Total likuiditete			217 380	378 444	172 303	43 023	953 090	2 416 082	2 425 868	634 924	842 221	1 459 263	1 750 084	2 255 828	2 878 824	992 321
Detyrime		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-1 700 000
Dhënë hua shtetasit S.V																
Kthim huaje nga shtetasi S.V																
Dhënë hua shtetases E.M																
Kthim huaje nga shtetasja E.M																
Dhënë hua vëllait P.Q																-1 700 000
Pasuri neto		600 000	217 380	161 064	-206 141	-129 280	910 067	1 662 992	9 786	3 761 456	207 297	617 042	711 451	505 744	1 889 396	9 071 512
Të ardhurat		2 163 489	646 927	892 802	1 005 701	950 384	1 148 377	2 600 161	1 272 235	1 530 132	1 656 379	1 655 122	1 648 704	1 252 341	1 851 102	2 153 554
Të ardhura nga punësimi subjekti		2 163 489	646 927	892 678	821 891	826 681	843 340	796 710	1 041 416	1 056 460	1 122 679	1 149 880	1 188 151	1 252 341	1 283 611	1 439 112
Të ardhura nga punësimi bashkëshortja								340 739	230 819	473 672	533 700	505 242	460 553	0	170 973	251 013
Të ardhura para martesës të bashkëshortes së subjektit deri në vitin 2008								477 252								
Të ardhura nga dhuratat motra V.K					183 810	123 703		492 730								
Të ardhura nga dhuratat nga motra A.P							302 275	492 730								
Të ardhura bashkëshortja e subjektit nga ekzekutimi I vendimit gjyqësor në vitin 2015																337 920
Të ardhura të përfituara nga leja e lindjes bashkëshortja e subjektit															58 598	103 629
Të ardhura në emër të bashkëshortes nga ekzekutimi I vendimit 2016																359 800
Të ardhura nga interesi i depozitës				124			2 762									
Shpenzime		621 864	93 864	287 776	109 557	233 260	234 557	626 615	1 134 230	918 136	560 310	564 096	566 900	1 063 536	1 179 089	1 175 460
Shpenzime në Intesa SanPaolo Bank për konferencë subjekti																28 203
Likuidim fature në BKT bashkëshortja e subjektit viti 2015																24 000
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së		621 864	93 864	93 864	109 557	109 557	136 620	273 240	409 860	409 860	546 480	564 096	564 096	879 992	1 121 380	1 175 460
Shpenzime qiraje te deklaruar nga subjekti pyetësori 4								6 000	36 000	15 500						
Shpenzime të deklaruar nga subjekti								463 000	490 000							
Shpenzime udhëtimi nga sistemi TIMS				193 912	0	123 703	97 937	347 375	225 370	2 776	13 830	0	2 804	183 544	5 506	0
Të ardhura - Pasuri - Shpenzime		941 625	335 683	443 962	1 102 285	846 404	3 753	310 554	128 219	-3 149 461	888 772	473 984	370 353	-316 940	-1 217 383	-8 093 418